

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5639
E martë, 27 nëntor 2018
çmimi 0.40 €

KFOR-i kërkon që
problemet në veri të zgjidhen
nëpërmjet dialogut | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NË PEJË ËSHTË MBAJTUR MBLEDHJA E PESTË E PËRBASHKËT NDËRMJET QEVERISË
SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË SHQIPËRISË | FAQE 4-5

Nëntori tregon fuqinë e shqiptarëve

- Thellohet bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri për heqjen e
taksave, të romingut dhe për unifikimin e doganave



Në prag të 28 nëntorit, Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë kanë thelluar bashkëpunimin, duke nënshkruar nëntë marrëveshje, protokolle dhe memorandumë bashkëpunimi. Me këto marrëveshje, të arritura në mbledhjen e pestë

të përbashkët të dy qeverive të mbajtur në Pejë, parashihet që brenda gjashtë muajve të unifikohen doganat, të hiqet romingu dhe masa të tjera. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se thellimi i

bashkëpunimit në mes të dy vendeve është i domosdoshëm, kurse kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se është koha për të vënë tarifa 100 për qind në veri dhe për të pasur tarifa zero në jug të Kosovës

'Epoka e re'
të gjithë
shqiptarëve
ua uron
28 Nëntorin!

AKTUALE

TAKSA PREJ 100
PËRQINDËSH
PËR MALLRAT
NGA SERBIA
DHE BOSNJA
NUK ËSHTË
RECIPROCITET,
MIRËPO DUHET TË
PËRKRAHET! F. 12



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

KOSOVA ANULON
PJESËMARRJEN NË FORUMIN
RAJONAL, SHKAK PREZANTIMI
I SAJ ME FUSNOTË F. 6

PREKAZI, VENDI QË
I BASHKON TË GJITHË
SHQIPTARËT F. 7

EKONOMI

KMDLNJ-ja: KEDS-i
DHE ZRRE-JA, ANKTHE
TË QYTETARËVE F. 9

VALON TOLAJ, DREJTOR
MENAXHUES I AKP-së F. 9

SPORT

PATRIOT BEHRAMI:
KRENARI TA FITOSH
TURNEUN 'ADEM JASHARI' F. 18

**Ambasada e
ShBA-së
kundërshton
taksën e
Kosovës ndaj
Serbisë** | FAQE 2

FLET PËR "EPOKËN E RE",
RRUSTEM BERISHA

**Dhjetori, muaj
i transformimit
të FSK-së
në ushtri** | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

**NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE**
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERKALBANDAR VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, 10000
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Policia serbe mbyll objektin e RTV Presheva

PRESHEVË, 26 NËNTOR - Të hënën inspektorati kundër zjarrit, me asistencë të Policisë serbe, ka mbyllur sërish institucione të Komunës së Preshevës, themelues i të cilave është Kuvendi Komunal i Preshevës. RTV Presheva ka bërë me dije se me këtë rast u është vënë dryni dyerve të hyrjes të Shtëpisë së Kulturës "Abdulla Krashnica", Bibliotekës "Mehmet Isufi", Radiotelevizionit "Presheva", Zyrës për të Rinj, duke iu shtuar

kësaj radhe edhe Zyra e Partisë Demokratike Shqiptare. "Lidhur me rivënien e drynit këtyre institucioneve, arsyejtimin se pse kjo po ndodh, nuk po e jep askush. Prandaj, vetvetiu lindin pyetjet: Kujt po i pengojnë këto institucione, me fajin e kujt po u vihet dryni për të dytën herë, kush dha leje për heqjen e drynit të vendosur ditë më parë, kush duhet dhënë përgjegjësi për këto, a ka të bëjë kjo rivendosje e drynit me festën e 28 Nëntorit,

Ditës së Flamurit apo është koincidencë?!", thuhet në reagimin e RTV Presheva. RTV Presheva përsërit se një gjë e tillë nuk mbahet mend të ketë ndodhur ndonjëherë në Komunën e Preshevës dhe se për Radiotelevizionin Presheva kjo është një goditje e radhës pasi ka gati një vit që nuk financohet nga Komuna e Preshevës, kurse tani i duhet pa fajin e saj të ballafaqohet edhe me këtë problem.



KFOR-i kërkon që problemet në veri të zgjidhen përmes dialogut

Në përmbyllje të mandatit njëvjeçar në krye të forcës paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë, Salvatore Cuoci u bëri thirrje autoriteteve të Kosovës, atyre të Serbisë dhe përfaqësuesve lokalë në veri të Kosovës, që të përmbahen dhe t'i zgjidhin problemet në mënyrë paqësore

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Komandanti në largim i KFOR-it, Salvatore Cuoci, u bëri thirrje autoriteteve të Kosovës, atyre të Serbisë dhe përfaqësuesve lokalë në veri të Kosovës, që të përmbahen dhe t'i zgjidhin problemet në mënyrë paqësore. "Pavarësisht a jetojnë në veri apo në jug, të çfarëdo përkatësi etnike qofshin, këshilla ime personale është të përmbaheni nga përdorimi i dhunës, provokimi dhe përleshjet", tha ai. Cuoci tha se vendosja e sovranitetit të plotë të institucioneve të Kosovës në komunat veriore të banuara me shumicë serbe mbetet ende sfiduese. Ai i bëri këto komente në një konferencë me gazetarë, duke folur për zhvillimet e javës

së kaluar në veri të vendit, kur Policia e Kosovës arrestoi katër pjesëtarë të komunitetit serb, tre nga të cilët në kuadër të hetimeve për vrasjen e politikanit lokal serb, Oliver Ivanović. Komandanti Cuoci tha se gjatë javës së fundit, për shkak të disa zhvillimeve ndërkombe të ekonomike, janë rritur tensionet, posaçërisht në veriun e Kosovës. "U bëj thirrje të gjithëve t'i zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë paqësore dhe me përgjegjësi, duke hedhur poshtë përdorimin e forcës dhe dhunës. Ne llogarisim nga të gjithë në rajon që të tregojnë përmbajtje dhe të mbështesin çdo përpjekje që çon në normalizimin e situatës së sigurisë dhe shmang krijimin e tension-



eve", tha ai, duke nënvizuar se Kosova ka arritur përparim të madh drejt normalizimit dhe do të ishte gabim shumë i madh t'i humbasë ato përparime, duke kthyer situatën prapa si para njëzet vjetëve. Komandanti Cuoci tha se koha e organizimit të operacionit

policor në veri të vendit ndonjëherë ofron edhe mundësinë për të qenë paksa e dyshimtë por kjo, sipas tij, është identifikuar dhe sqaruar me institucionet në Kosovë. "Natyrshisht kur operacioni i policisë ndodh në kohën kur tensionet mund të rriten, është shumë rrezik

dhe kjo është diçka që ne kërkojmë të bashkërendojmë me qëllim të parandalimit të rritjes së tensioneve. Ne mund të jemi efektivë në çdo kohë, por ne nuk kemi nevojë t'i rrisim tensionet, veçanërisht kur ka shumë çështje në terren që po ndodhin", tha ai. Ai tha se duhet edhe bashkëpunimi i Beogradit për ta kontrolluar situatën.

Operacioni i policisë nxiti reagime të shumta në veriun e Kosovës dhe autoriteteve në Serbi, në një periudhë tensionesh të larta politike pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për një taksë prej 100 përqindësh ndaj mallrave nga Serbia, që nxiti zemërimin e Beogradit, edhe thirrjet e Bashkimit Evropian për heqjen e takës.

Kosova e Serbia janë përfshirë në një proces bisedimesh për normalizimin e marrëdhënieve, që është kusht për integrimet evropiane. Por, vazhdimi i këtij procesi duket i vështirë pas zhvillimeve të fundit politike.

Banorët e "Unazës së Re" përplasen me policinë

TIRANË, 26 NËNTOR - Ministria e Infrastrukturaes ka nxjerrë të hënën në terren grupet e punës së ARRSh-së, Bashkisë së Tiranës dhe ALUJZIN-it, për t'i verifikuar pronat që do të shemben, pasi preken nga projekti i ndërtimit të "Unazës së Re" në Tiranë. Banorët nuk kanë pranuar që pronat e tyre që vlerësohen nga këta inspektorë pa marrë garanci se dëmshpërblimi do të jetë në masën 100%. Mes tyre ka pasur përplasje. Inspektorët e institucioneve shtetërore, veç regjistrimit të pronave, kanë nisur edhe

punën për zhvendosjen e disa objekteve publike, siç janë shtyllat e ndriçimit, për t'i hapur rrugën nisjes së punimeve për unazën e re. Ky moment ka shënuar edhe rritjen e tensionit mes banorëve dhe policisë që është e pranishme në terren. Më herët, Ministria e Infrastrukturaes bëri të ditur se "inxhinierët e ARRSh poshkojnë në ato objekte banorët e të cilëve kanë depozituar pranë këtij institucioni dokumentacione e pronësisë dhe kanë kërkuar të vazhdohen verifikimet dhe procedura e

shpronësimit". Po sipas Ministrisë, prania e policisë ka qenë e detyrues për shkak të kërcënimeve që inspektorët kanë marrë nga banorët. "Gjatë punës në terren banorë të tjerë të zonës, që nuk kanë lidhje me objektet të cilat po verifikohen, kanë penguar me dhunë inxhinierët në ushtrimin e detyrës. Ata kanë dhunuar edhe mjediset private të banorëve me dokumentacion e pronësisë të cilët kanë qenë të pranishëm dhe të gatshëm për verifikimin e banesës në funksion të shpronësimit", ka njoftuar Ministria e Infrastrukturaes.



Flet për "Epokën e re", Rrustem Berisha

Dhjetori, muaj i transformimit të FSK-së në ushtri

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Rrustem Berisha, ka bërë me dije se janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për ta shënuar Ditën e Forcës, 27 nëntorin, me ç'rast qytetarët do të mund t'i vizitojnë kazernat ku do të prezantohen pajisjet e kësaj force. Në një bisedë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo festë e gjen FSK-në më të përgatitur se kurrë më parë. Sipas Berishës, ky ka qenë një vit jashtëzakonisht i suksesshëm për FSK-në. Ministri Berisha ka paralajmëruar se gjatë muajit dhjetor Kuvendi i Republikës së Kosovës do t'i votojë në shqyrtim të dytë tri projektligjet me të cilët parashihet transformimi i FSK-së në ushtri



**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Sot (e martë) me aktivitete të ndryshme do të shënohet Dita e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Me këtë rast, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se kjo ditë do të jetë e hapur për qytetarët të cilët do të mund t'i vizitojnë kazernat e FSK-së dhe t'i shohin nga afër pajisjet e forcës. "Sot (e martë) me disa aktivitete do ta shënojmë Ditën e Forcës. Forca e Sigurisë së Kosovës do ta ketë një ditë të hapur, ku do t'i prezantojë pajisjet individuale, kolektive dhe ku do të jetë një mundësi e mirë që edhe qytetarët, përkatësisht fëmijët tanë, ta vizitojnë FSK-në dhe nga afër të njohohen me të arriturat e saj", ka deklaruar Berisha, duke shtuar se kjo ditë e ka gjetur FSK-në më të përgatitur se asnjëherë më parë. Në këtë kontekst, ai ka thënë se FSK-ja vazhdon të jetë institucioni më i besuar dhe më i përkrahur në vend. "Dita e FSK-së e ka gjetur organizatën më të përgatitur si asnjëherë më parë,

edhe pse FSK-ja vazhdon të jetë edhe më tutje institucioni më i besuar dhe më i mbështetur në vend. Kjo është falë angazhimit dhe përkushtimit të pjesëtarëve të FSK-së dhe të partnerëve tanë me të cilët bashkëpunojmë në baza ditore. Pra, çdo përvjetor e kremtojmë me të arritura dhe me suksese të reja", ka theksuar ministri Berisha.

Ai ka vlerësuar se ky ka qenë një vit jashtëzakonisht i suksesshëm për FSK-në. "Është një vit jashtëzakonisht i suksesshëm i FSK-së sepse kemi pasur progres dhe zhvillime pozitive. Një prej këtyre zhvillimeve është mirëmbajtja dhe avancimi i kapaciteteve operationale që ka FSK-ja. Zhvillim tjetër pozitiv është edhe procedimi dhe miratimi në lexim të parë i tri projektligjeve për transformimin e FSK-së. E veçanta e miratimit të këtyre projektligjeve është vota unanime e të gjitha subjekteve politike shqiptare, por edhe e atyre të komuniteteve të tjera, përveç komunitetit serb. Gjithashtu, kemi arritur ta avancojmë bashkëpunimin rajonal, por edhe bashkëpunimin me partnerët

tanë strategjikë. Mendoj se edhe në të ardhmen do të punojmë në këtë drejtim sepse rajoni do ta ketë një forcë aleate e cila do të jetë në shërbim të paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në rajon dhe më gjerë", ka thënë ai.

Ministri Berisha ka paralajmëruar se gjatë muajit dhjetor Kuvendi i Republikës së Kosovës do t'i votojë në shqyrtim të dytë tri projektligjet me të cilët parashihet transformimi i FSK-së në ushtri. "Procesi është në

procedurë të rregullt dhe është çështje e kryesisë dhe e Kuvendit se kur do të vendosin që tri projektligjet për FSK-në të shqyrtohen edhe në leximin e dytë. Nuk kam informacione për datën e saktë, por pritjet tona janë që gjatë muajit dhjetor të miratohet Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës", është shprehur Berisha, duke shtuar se edhe në leximin e dytë

pret një votë unanime të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. "Deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë dëshmuar përkrahjen dhe votën unanime për transformimin e FSK-së në shqyrtimin e parë të këtyre tri projektligjeve dhe presim një votë unanime edhe në shqyrtimin e dytë të tyre. Vota unanime e deputetëve të Kuvendit pro transformimit të FSK-së na ka bërë krenarë neve dhe të gjithë pjesëtarët e FSK-së", ka theksuar Berisha.



Ambasada e ShBA-së kundërshton taksën e Kosovës ndaj Serbisë

PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER) - E ngarkuara me punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Colleen Hyland, e ka cilësuar të dëmshme vendosjen e taksës së Kosovës ndaj produkteve të Serbisë. Ajo ka thënë se

rritja e taksave ndaj Serbisë nënkupton rritje të tensioneve dhe rritje të dëmtimit të reputacionit të Kosovës. "Rritja e tarifave për anëtarët e CEFTA-s është e barabartë me rritjen e dhimbjes për qytetarët e Kosovës, rritjen e tensioneve dhe rritjen e dëmit të

reputacionit të Kosovës. Udhëheqje strategjike, jo reagime emocionale, është e nevojshme për të siguruar të ardhmen evropiane të Kosovës dhe normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë", ka shkruar Hyland në llogarinë e vet në "Facebook".

Në Pejë është mbajtur mbledhja e pestë e përbashkët ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Shqipërisë

Nëntori tregon fuq

- Thellohet bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri për heqjen e taksave, të romingut dhe për unifikimin e doganave

Në prag të 28 nëntorit, Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë kanë theluar bashkëpunimin, duke nënshkruar nëntë marrëveshje, protokolle dhe memorandume bashkëpunimi. Me këto marrëveshje, të arritura në mbledhjen e pestë të përbashkët të dy qeverive të mbajtur në Pejë, parashihet që brenda gjashtë muajve të unifikohen doganat, të hiqet romingu dhe masa të tjera. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se thellimi i bashkëpunimit në mes të dy vendeve është i domosdoshëm, kurse kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se është koha për të vënë tarifa 100 për qind në veri dhe për të pasur tarifa zero në jug të Kosovës

këtë kontekst kaq të posaçëm goditjesh të vazhdueshme pas shpine ndaj Kosovës nga ana e fqinjit të madh, merr edhe shpjegimin tarifa 100 për qind për produktet serbe. Një vendim irracional në kushte normale, por krejt normal në kushte irracionaliteti, si ato që përvijon vijimisht qasja e dyfytërisë së Serbisë. Kush e sheh tarifën 100 për qind si vendim ekonomik, gabon. Tarifa 100 për qind është reagim politik. Reagim politik ndaj ekseseve të vazhdueshme të një sjelljeje supematiste të Serbisë ndaj Kosovës", ka thënë Rama, duke treguar se çfarë do të bëhet në pjesën e parë të vitit të ardhshëm në bashkëpunimin në mes të dy vendeve. "Zero tarifa dhe zero barriera jotarifore bren-

të shkohet edhe drejt bashkimit doganor. "Transit më 1 janar në Portin e Durrësit për Kosovën dhe hapa të tjerë brenda gjashtëmuajorit të ardhshëm drejt bashkimit doganor. Kush e konsideron këtë si kërcënim, qoftë në Beograd, qoftë në Bruksel, është i mirëpritur të vijë, të ulet në tavolinë, t'i shpjegojmë që nuk është kërcënim, por një ftesë që të gjithë të tjerët të marrin shembull nga ky bashkëpunim dhe Serbia e para ta ndjekë shembullin e këtij bashkëpunimi", ka thënë ai.

Kryeministri shqiptar ka vlerësuar se duhet të ndodhë njohje e plotë e gjithë dokumenteve brenda gjashtëmuajorit. "Boll u bënë vite të tëra pavarësi, u bënë vite të tëra mbledhje dhe shprehje qëllimesh të mira. Sot vazhdojnë të kërkohen dy palë dokumente për lopët, për viçat, për delet andej e këtej. Një palë dokumente dhe brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit të ardhshëm, çfarë jepet në Kosovë si dokument, duhet të konsiderohet dokument i nxjerrë në Shqipëri. Çfarë jepet në Shqipëri si dokument, duhet të konsiderohet dokument i nxjerrë në Kosovë dhe sipërmarrësit shqiptarë të Kosovës apo të Shqipërisë mjafton të shkojnë në një derë dhe jo të shkojnë në dy dyer. Ne nuk jemi shqiptarët dhe serbët. Ne jemi shqiptarët dhe shqiptarët", ka thënë Rama. Pas përfundimit të mbledhjes së nënshkrimit të marrëveshjeve, të dy kryeministrat kanë nënshkruar mbi një flamur kombëtar dhe janë betuar mbi të, duke u zotuar se do ta thellojnë bashkëpunimin në mes të dy vendeve. Fare në fund, anëtarët e dy kabineteve kanë realizuar edhe një fotografi të përbashkët, duke bërë me duar shqiptonjën, simbolin kombëtar



të shqiptarëve.

Rama: Kush ngre dorën ndaj Thaçit duke e quajtur tradhtar, është gomar

Pas mbledhjes së përbashkët të dy qeverive, të dy kryeministrat kanë mbajtur konferencë për medie, në të cilën janë deklaruar edhe për çështjen e korrigjimit të kufjeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kryeministri Rama ka mbrojtur presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, duke thënë se kush e quan Thaçin tradhtar është gomar. "Sa i përket çështjes së korrigjimit unë një gjë kam për të thënë. Hashim Thaçi është president i Kosovës dhe komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kush ngre dorën ndaj Hashim Thaçit duke e quajtur tradhtar, është gomar. Këtë di ta them unë", është shprehur Rama.

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë janë pajtuar që brenda gjashtë muajve t'i unifikojnë doganat, t'i heqin tarifën e romingut në kuadër të telekomunikimit. Në mbledhjen e pestë të përbashkët ndërmjet dy qeverive, të mbajtur të hënën në Pejë, janë dhënë dy informata dhe janë nënshkruar gjashtë marrëveshje, dy protokolle dhe një memorandum. Në hapjen e kësaj mbledhje, të dy kryeministrat kanë deklaruar se thellimi i bashkëpunimit ndërmjet të dy vendeve është më se i domosdoshëm.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka treguar se janë të vetëdijshëm që populli i Kosovës dhe ai i Shqipërisë presin më shumë nga të dy qeveritë, duke shtuar se nga këtu do të vazhdojnë pandalshëm me punët që i presin. "Kam nderin ta shpall të hapur mbledhjen e dy qeverive, të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, e pesta me radhë, që po mbahet në Pejë. Jam i lumtur për të arriturat e këtij takimi të përbashkët dhe jam i bindur se mundësia që të nënshkruajmë nëntë marrëveshje dhe protokolle do të çojë në një të ardhme të afërt deri në unifikimin e ekonomive tona dhe jo vetëm kaq", ka thënë Haradinaj.

Më tej, ai ka folur për punët që i ka kryer Kosova në planin e jashtëm dhe të brendshëm. "Sot Kosova është palë kontaktuese me BE-në, MSA-në, zbaton prioritetet e reformës evropiane, njëkohësisht ka përmbushur me sukses 95 obligimet e veta, pra njëqind për qind, për liberalizimin e vizave", është shprehur ai, duke shtuar se të dy qeveritë duhet të mbështeten te njëra-tjera. "Shqipëria çdoherë ka mundur të llogarisë në Kosovën dhe çdoherë

ka të drejtë të llogarisë në të, por edhe Kosova çdoherë ka llogaritur në Shqipërinë, e kjo është dëshmuar në vitin '99, në ditët më të vështira të jetës sonë si komb", ka thënë Haradinaj.



Ndërsa kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka folur për pengesat që Serbia po i bën Kosovës në të gjitha fushat. Ai ka përmendur edhe vendosjen e taksës doganore nga ana e autoriteteve të Kosovës për prodhimet me origjinë nga Serbia dhe Bosnja, duke thënë se kjo taksë ishte reagim ndaj padrejtësive që i bëhen Kosovës. "E pra, ja se si në

da gjashtëmuajorit të parë të vitit të ardhshëm në mes të Shqipërisë dhe Kosovës. Nëse jemi këtu, jemi këtu për të bërë këtë e duhet ta bëjmë e nuk kemi nevojë të mblidhemi edhe një herë. Jemi mbledhur pesë herë, sot është koha për të vënë tarifa 100 për qind në veri dhe për të pasur tarifa zero në jug të Kosovës", është shprehur ai. Sipas Ramës, duhet



inë e shqiptarëve



Sipas tij, Shqipëria është e interesuar të ndërtojë raporte strategjike me Serbinë. "Por, Serbia nuk duhet t'i përdorë dy fytyra, një me Kosovën e një me Shqipërinë. Kjo është e papranueshme. Serbia nuk është viktimë. Kosova është viktimë. Shqipëria dhe Kosova do të ecin dorë për dorë si dy shqiponja krenare", ka deklaruar Rama. Kurse kryeministri Ramush Haradinaj ka ripërsëritur edhe një

herë qëndrimin e vet lidhur me lëvizjen e kufijve, duke thënë se askush nuk do ta prekë asnjë milimetër tokë të Kosovës. "Kush mendon se merr tokë prej Kosovës e ka gabim. A ke prej Kosovës a Shqipërisë, a ke Edi a Ramushi, askush s'do të marrë tokë prej Kosovës. 17 shkurti nuk preket më. Kur është gati Serbia për të na njohur, mirë se vjen! Është gabim të mendohet për zgjidhje territoriale. Nëse duhet të



flasin për kufijtë, atëherë kanë të drejtë vetëm shqiptarët", është shprehur Haradinaj.

Këto janë nëntë marrëveshjet që u nënshkruan në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

Në mbledhjen e pestë të përbashkët ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë janë dhënë dy informata dhe



janë nënshkruar gjashtë marrëveshje, dy protokolle dhe një memorandum, nga ministrat përkatës të dy qeverive.

Informata e parë ka të bëjë me të arriturat për vendosjen e Pikës Doganore të Republikës së Kosovës në Portin e Durrësit dhe informata e dytë ka të bëjë me Deklaratën e objektivave të përbashkëta për themelimin e Dhomës Ekonomike Bilaterale Shqipëri - Kosovë.

Pas përfundimit të mbledhjes është zhvilluar ceremonia solemne e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërmjet dy qeverive. Marrëveshjet, protokollet dhe memorandumet e nënshkruara ndërmjet ministrave përkatës të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të

Fatmir Limaj emërohet koordinator kombëtar i dy qeverive

Me propozim të kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, dhe me miratimin e dy qeverive Kosovë - Shqipëri, zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, është emëruar koordinator kombëtar i dy qeverive për mbikëqyrjen dhe zbatimin e marrëveshjeve të arritura mes dy vendeve. Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, më herët është votuar në Qeverinë e Kosovës si koordinator për organizimin e mbledhjeve mes dy qeverive shqiptare.

4. Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e borxhit publik, financimeve të huaja dhe marrëdhëniet me institucionet financiare ndërkombëtare;

5. Marrëveshja për heqjen e çmimeve të shërbimeve roaming për rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme ndërmjet ministrave përgjegjës për fushën e komunikimeve elektronike të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës;

6. Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e rinisë;

7. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim në fushën e shëndetësisë;

8. Protokollin ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës, për njohjen e bilaterale dhe unifikimin e modeleve të certifikatave shëndetësore, veterinarë dhe fitosanitare që do t'i shoqërojnë ngarkesat e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve bimore gjatë importit, eksportit dhe transitit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës

9. Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Agjencisë për Pronësinë Industriale të RKS-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë.

Republikës së Shqipërisë, janë si më poshtë:

1. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe të informimit të diasporës;

2. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për njohjen reciproke të patentëshoferëve;

3. Protokollin për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit doganor në pikën e përbashkët të kalimit kufitar Morinë - Vermicë në mes të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë;

Thaçi dhe Veseli e përshëndesin mbledhjen e përbashkët të dy qeverive

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mirëpritur mbajtjen e mbledhjes së përbashkët në mes të dy qeverive shqiptare, duke thënë se mbledhjet e tilla janë të rëndësishme për bashkëpunimin e prioritetive dhe interesave strategjike të dy shteteve. "Mbledhjet ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Shqipërisë janë shumë të rëndësishme për

bashkëpunimin e prioritetive dhe interesave strategjike të shteteve tona. Vendimet e sotme të dy qeverive janë një hap tjetër i rëndësishëm drejt arritjes së synimeve tona strategjike për bashkimin e shqiptarëve nën ombrellën e Bashkimit Evropian. Këto dhe vendime të tjera do të ndikojnë në largimin e barrierave për qytetarët dhe rritjen ekonomike

bazuar në vlerat e Bashkimit Evropian", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka përshëndetur punimet e mbledhjes së përbashkët të Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, duke thënë se nënshkrimi i marrëveshjeve është në të mirë të qytetarëve. "Përshëndes punimet e mbled-

hjes së përbashkët të qeverive të dy vendeve tona, Kosovës dhe Shqipërisë. Nënshkrimi i marrëveshjeve që forcojnë lidhjet tona ekonomike, arsimore, kulturore dhe në shumë fusha të tjera, janë një zhvillim pozitiv për qytetarët tanë. Unë besoj se këto marrëveshje, por edhe të tjerat që do të nënshkruhen në të ardhmen, do të gjejnë zbatim të menjëhershëm dhe efikas, e

jo të mbesin vetëm pjesë e diskursit tonë publik. Vetëm duke bashkëpunuar ngushtë me njëri-tjetrin, duke e ndihmuar njëri-tjetrin, duke promovuar bashkë vlerat tona, ne ndërtojmë një jetë më të mirë për qytetarët tanë dhe një të ardhme më të ndritur për gjeneratat e reja", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ministri Mustafa po merr pjesë në forumin rajonal në Sofje

PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, me ftesë të ministrit të Brendshëm të Bullgarisë, Mladen Marinov, po merr pjesë në punimet e "Forumit rajonal të ministrive të brendshme për kundërveprim ndaj korrupsionit të brendshëm", i cili po mbahet në Sofje të Bullgarisë.

Qëllimi kryesor i forumit është zgjerimi i bashkëpunimit operacional në kundërveprim ndaj korrupsionit të brendshëm si dhe diskutimi i mundësive për më shumë aktivitete të përbashkëta në nivel rajonal sa i përket këtij bashkëpunimi.

Me iniciativën e Bullgarisë, në

vitin 2016 u krijua një rrjet për bashkëpunim të zgjeruar rajonal të njësive të sigurisë së brendshme (NERCISU) me pjesëmarrjen e njësive përkatëse të Ministrive të Punëve të Brendshme të disa vendeve ballkanike. Rrjeti funksionon si një platformë për bashkëpunim aktiv rajonal operacional me linjën 24/7 për koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe inteligjencës.

Me këtë rast, ministri Mustafa në diskutimin e tij ofroi bashkëpunimin e plotë të MPB-së së Republikës së Kosovës dhe të gjitha agjencive nën autoritetin e saj, përfshirë edhe Policinë e

Kosovës. Ministri Mustafa u bëri thirrje kolegëve të tij nga vendet e tjera të rajonit të lënë mënjane çfarëdo kundërshtimi që mund të ekzistojë ndërmjet tyre si rezultat i qëndrimeve politike dhe pikëpamjeve të ndryshme. "Duke bashkëpunuar në fushën e sigurisë, ne do të jemi më afër njëri-tjetrit edhe për zgjidhjen e marrëveshjeve politike ende të pranishme në Evropën Juglindore", ka thënë ministri Mustafa. Ai mori shembull marrëdhëniet e mira ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Bullgarisë, si një frymëzim për bashkëpunim të mundshëm kudo.



Kosova anulon pjesëmarrjen në Forumin Rajonal, shkak prezantimi i saj me fusnotë

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Koordinatorin Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, njëherësh zëvendësiministër i Drejtësisë, Naim Qelaj, ka anuluar pjesëmarrjen në Forumin Rajonal "Promovimi dhe implementimi i Konventës së Stambollit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi" që do të mbahet në Shkup më 27 dhe 28 nëntor për arsye se organizatorët e këtij forumi, mbishkrimet e përfaqësuesve të Kosovës i ka vënë me fusnotë dhe Rezolutën 1244, duke anashkaluar kështu mendimin e GjND-së dhe Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës. "Më duhet t'ju njoftoj se unë nuk mund të marr pjesë në konferencën rajonale që mbahet në Shkup pa emërtimin e plotë të institucionit që përfaqësoj dhe pozitës që mbaj. Me keqardhje ju njoftoj se më duhet ta anuloj konfirmimin tim për pjesëmarrje përderisa nuk trajtohem të barabartë me të tjerët. Pres nga organizatorët të veprojnë dhe të na mundë-



sojnë pjesëmarrjen tonë me evitimin e fusnotës ose të shënohet edhe mendimi i GjND-së dhe Deklarata e Pavarësisë së Kosovës", është thënë në reagimin e koordinatorit Nacional për Mbrojtje nga

Dhuna në familje, Naim Qelaj. Vendimi për mospjesëmarrje i Qelajt është përkrahur edhe nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, nga Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës dhe nga KIPRED-i. Nga Kosova në këtë

forum është paraparë të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve të vendit si dhe shoqërisë civile, ku do diskutohet implementimi i Konventës së Stambollit në vendet e Ballkanit perëndimor dhe

Turqisë, veçanërisht për punën që po bëhet për mbrojtjen nga dhuna në familje. Konferenca është organizuar nga Unioni Evropian, Këshilli i Evropës, UN Women, nën përkujdesjen e Qeverisë së Maqedonisë.

Studentët e Universitetit 'Kadri Zeka' bashkë me rektorin vizitojnë Shqipërinë

GJILAN, 26 NËNTOR (ER) - Rektori i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, Bajram Kosumi, bashkë me studentët, nën udhëheqjen e kryetarit të Parlamentit Studentor, Adrian Bajrami, kanë qëndruar në një vizitë në Shqipëri. Ata kanë qëndruar në Presidencën e Shqipërisë, ku janë pritur në një takim nga presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta. Presidenti Meta ka mirëpritur takimin me

studentët dhe rektorin e UKZ-së, derisa ka thënë se takimet me të rinjtë shqiptarë nga Kosova janë përherë të ngrohta dhe emocionuese. Ai është shprehur shumë i lumtur të bashkëbisedojë me studentët. "Ndiem shumë i lumtur të bashkëbisedoj me studentët e shkëlqyer të Universitetit Publik 'Kadri Zeka' të Gjilanit, që mban emrin e poetit, prozatorit dhe veprimtarit të paepur

për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, heroit Kadri Zeka", ka thënë Meta. Në këtë takim u tha se rinia duhet të jetë promotore e proceseve demokratike dhe integruese në të dyja vendet tona.

Paraprakisht studentët e Universitetit Publik "Kadri Zeka" kanë vizituar edhe Parlamentin e Shqipërisë, ku janë njoftuar më afër rreth punës së këtij institucioni.



Kjo vizitë është realizuar në kuadër të veprimtarive që organizohen për nder të festimit të

Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe Ditës së Flamurit Kombëtar.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ai i Kosovës, Ramush Haradinaj dhe kryeparlamentari Kadri Veseli kanë bërë homazhe në Prekaz

Prekazi, vendi që i bashkon të gjithë shqiptarët

"Nuk ka vend më të përshtatshëm se Prekazi për t'i uruar të gjithë shqiptarët kudo që janë për festën e flamurit kuq e zi, flamurit me shqiponjën dykrenare, që është simboli që duhet të na inspirojë çdo ditë për të qenë një trup dhe dy shtete, me sytë drejt bashkimit tonë kombëtar në Evropën e Bashkuar", ka thënë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, pasi ka bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, në vigjilje të festave të nëntorit



nëntorit, bashkë me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama,

kryeparlamentarin Kadri Veseli, zëvendëskryeministrat dhe ministrat nga të dyja qeveritë. Fillimisht kryeministri Haradinaj dhe kryeministri Rama kanë vizituar kullën e Jasharëve, ku janë pritur nga Rifat Jashari, vëllai i komandantit legjendar Adem Jashari. Pas vizitës në kullë, kryeministri Haradinaj dhe kryeministri Rama, të shoqëruar edhe nga kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli dhe kryefamiljari i familjes Jashari, Rifat Jashari, kanë vënë kurora me lule te varri i komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka vlerësuar se Prekazi është vendi ku i bashkon të gjithë shqiptarët, duke thënë se ka nderin që bashkë me kabinetin e Shqipërisë dhe kryeministrin Rama të bëjnë homazhe në Prekaz.

Ndërkaq kryeministri Edi Rama

ka falënderuar për mikpritjen dhe mundësinë që ta nderojnë historinë e lavdishme të kësaj familje, kësaj toke. "Nuk ka vend më të përshtatshëm se Prekazi për t'i uruar të gjithë shqiptarët kudo që janë për festën e flamurit kuq e zi, flamurit me shqiponjën dykrenare, që është simboli që duhet të na inspirojë çdo ditë për të qenë një trup dhe dy shtete me sytë drejt bashkimit tonë kombëtar në Evropën e Bashkuar", ka thënë kryeministri Rama. Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se dita e flamurit është shpresë, perspektivë, bashkim dhe ecje përpara në realitetin në të cilin jemi. Rifat Jashari, vëllai i komandantit legjendar Adem Jashari, falënderoi të dy kabinetet qeveritare për vizitën, duke uruar festat e nëntorit. "Uroj që gjithmonë të jemi bashkë ashtu sikur jemi sot këtu", ka thënë Rifat Jashari.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PREKAZ, 26 NËNTOR - "Nderi dhe lavdia është për të rënë për liri, por edhe ne do të rrugëtojmë në

rrugën e tyre", ka thënë kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, pasi ka bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, në vigjilje të festave të



Kroacia do të llobojë për liberalizimin e vizave për Kosovën

PRISHTINE, 26 NËNTOR (ER) - Komisioni për Integritet Evropian i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Blerta Deliu-Kodra, kryetare, ka pritur të hënën në takim Komisionin për Çështje Evropiane të Parlamentit të Kroacisë, të kryesuar nga Ivan Miloseviq, kryetar, i cili po qëndron për vizitë zyrtare në vendin tonë. Kryetarja Deliu-Kodra, duke i uruar delegacionit të Parlamentit të Kroacisë mirëseardhje në Kosovë dhe në kuvendin e saj, falënderoi shtetin kroat për gjithë mbështetjen që e ka dhënë për Kosovën në kohë dhe rrethana ta ndryshme. Ajo foli edhe për objektivat e shtetit të Kosovës, si liberalizimi i vizave dhe integrimi evropian në përgjithësi, që domosdoshmërisht kërkojnë mbështetje nga vendet që kanë kaluar nëpër këto procese, siç

është Kroacia. Ndërsa Ivan Miloseviq, duke shprehur kënaqësinë që gjendet për vizitë në Kosovë, shprehu bindjen se shteti që ai përfaqëson do të jetë vazhdimisht përkrahës i Kosovës nëpër proceset që do të kalojë ajo. Ai ka theksuar përkushtimin për ta forcuar bashkëpunimin midis dy vendeve edhe në fusha të tjera, si ekonomia, arsimit etj. Gjatë diskutimit, anëtarët e tjerë të komisionit ritheksuan lidhjen e ngushtë që kanë këto dy shtete në bazë të së kaluarës, e cila, siç u tha, i lidh emocionalisht të dy popujt. Ata shprehën gatishmërinë që e ardhmja të jetë me bashkëpunim edhe më të ngushtë midis parlamenteve dhe vendeve përkatëse. Po ashtu, deputetët thanë se rëndësia e kësaj marrëdhënie në mes shtetit të Kosovës dhe atij kroat bëhet edhe më e ngushtë



për shkak të partneritetit strategjik dhe synimeve të përbashkëta euroatlantike. Anëtarë të delegacionit kroat, nga ana e tyre, trajtuan tema si liberalizimi i vizave për Kosovën dhe

anëtarësimi në institucionet evropiane dhe botërore. Ata thanë se Kroacia i jep mbështetje dhe do të llobojë për çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën. Pas takimit, të dy

kryetarët mbajtën konferencë për media dhe u përgjigjën në pyetjet e gazetarëve.

Në frymë miqësie e bashkëpunimi u zhvillua edhe takimi midis mysafirëve kroatë dhe Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike të Kuvendit të Kosovës.

Zëvendëskryetarja e Komisionit për Punë të Jashtme, Time Kadriaj, e cila drejtoi takimin, ka thënë se komisionet parlamentare dhe vizitat si kjo mund të shërbejnë si ura të rëndësishme bashkëpunimi midis dy vendeve, në funksion të forcimit të miqësisë e të marrëdhënieve midis dy vendeve.

Kadriaj ka theksuar nevojën e vazhdimin të mbështetjes së mëtejme të Zagrebit zyrtar për Kosovën si në rrafshin ndërkombehtar, po ashtu edhe të zhvillimit të brendshëm.

Latifi del t'i shohë projektet që janë duke u realizuar në Rahovec

RAHOVEC, 26 NËNTOR (ER) - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka vizituar disa prej projekteve që janë duke u realizuar në vendbanime të ndryshme brenda komunës. Ai u shoqërua nga drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Berat Duraku, dhe nga Artan Asllani, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm. Projektet që ata shkuan t'i shohin nga afër

janë: rregullimi i varrezave të dëshmorëve në Nagac, ndërtimi i rrugës Krushë e Madhe - Randobravë, ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Xërxë, kompleksi i dëshmorëve në Gradish, ndërtimi i e tregut të rrushit në Rahovec, ndërtimi i shtegut për ecje drejt "Maja e Shkodranit" dhe projektin për mbjelljen e drunjve dekorativë në fshatin Drenoc.



Në Mitrovicë do të organizohen aktivitete të shumta për 28 Nëntorin

MITROVICË, 26 NËNTOR (ER) - Drejtuar nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e bordit të drejtorëve, në të cilën janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i bordit dhe drejtorive komunale. Fillimisht fjalën e mori drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, i cili, pas një fundjave me plot aktivitete në qytetin e Mitrovicës, i ka njoftuar anëtarët e bordit me rastin e festës së 28 nëntorit, se është bërë stolisja e

qytetit me flamurin kombëtar, ndërsa ka paralajmëruar një agjendë të pasur kushtuar Ditës së Flamurit Kombëtar. Drejtori Peci ka thënë se të mërkurën do të mbahen homazhe pranë varrezave të dëshmorëve në Shipol, për të vazhduar te shtatorët e dëshmorëve Avni Shabani, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Fatime Hetemi, Artim Jashari, Safet Boletini, Shemsi Ahmeti, Mehë Uka, heroit kombëtar Isa Boletini, pastaj do të ketë vizitë edhe në kullën e Isa Boletinit

dhe në mbrëmje në sheshin e qytetit do të ketë edhe një koncert festiv ku do të përformojnë këngëtarët tanë më të njohur. Ndërkaq drejtori i Arsimit, Iset Beka, ka njoftuar ekzekutivin për programin kombëtar me nxënës dhe të rinj i cili tashmë do të organizohet nga Ministria për Arsimit, Shkencë dhe Teknologji, ku të gjitha garat e volejbollit, gjuhës dhe letërsisë, artit, të matematikës, do të organizohen në nivel shkollor, komunal, republikan si dhe ndërshtetëror.



Bekim Jashari: Mësuesi Halit Geci do të mbetet gjithmonë në kujtesën tonë

SKENDERAJ, 26 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka përkujtuar mësuesin Halit Geci, i cili është vrasur 21 vjet më parë nga forcat serbe. Jashari ka thënë se kanë kaluar më shumë se dy dekada nga vrasja e tij, e do të kalojnë edhe shekuj, por mësuesi Halit Geci do të mbetet gjithmonë në kujtesën tonë heroike. "Kaluan më shumë se dy dekada nga vrasja e tij, do të kalojnë edhe shekuj, por mësuesi Halit Geci do të mbetet gjithmonë në mendjet tona, në kujtesën heroike, për veprën e tij të palodhshme që edukonte

nxënësit. Ngjarja e 21 vjetëve më parë, të aksionit të ndërmarrë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës ndaj makinerisë vrasëse serbe të asaj kohe dhe vrasja e mësuesit Halit, janë të freskëta në kujtesën tonë kolektive. Varrimi i tij ishte i bujshëm, pasi do të shënonte në histori momentin e daljes për herë të parë në publik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka shkruar Jashari në llogarinë e tij në "Facebook". Ai është zotuar se do të punojë për një arsim më të mirë, më cilësor, në mënyrë që nxënësit të arsimohen dhe t'i shërbejnë vendit. "Sot, në

Shkollën Filllore 'Halit Geci' në Llaushë, në praninë e nxënësve, prindërve, kolektivit të shkollës, ish-komandantit të Brigadës 112 të UÇK-së, Jetullah Geci, e gjeneralit të FSK-së, Xhevahir Geci, duke shënuar ditën e shkollës, kemi kujtuar edhe mësuesin e urtë Halit Geci. Do të punojmë së bashku më shumë për një arsim më të mirë, më cilësor, që nxënësve t'u krijojmë kushte të përshtatshme të mësimi, në mënyrë që pasi të jenë arsimuar, t'i shërbejnë vendit tonë të dashur. Bekuar qoftë emri yt, mësues Halit!", ka thënë theksuar Jashari.

Filloi aksioni vjeshtor në Prishtinë për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme

PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER) - Në kuadër të politikave për një qytet sa më të pastër, Komuna e Prishtinës, nëpërmjet kompanisë së kontraktuar "Pastrimi", organizon aksionin vjeshtor për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme, si: orendi,

shtretër druri ose metali, dolapë druri ose metali, tavolina druri ose metali, karrige druri ose metali, pajisje të kuzhinës, gjësende të tjera shtëpiake nga druri dhe metali. Aksioni do të zhvillohet pesë ditë, në pesë zona të ndryshme të kryeqytetit.



Valon Tolaj, drejtor menaxhues i AKP-së

PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER) - Ish-këshilltari i kryeministrit Ramush Haradinaj, Valon Tolaj, është emëruar drejtor menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Vendimi për emërimin e Tolajt është marrë nga bordi i drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e rregullt e cila është mbajtur të hënën. Mandati i drejtorit menaxhues të AKP-së është

katërvjeçar. Po ashtu, në mbledhjen e bordit të drejtorëve është miratuar transaksioni nga shitja e asetëve në likuidim SHAL 42 si dhe propozimet për aprovim të listës së shitjes së asetëve në likuidim SHAL 43A. "Në këtë mbledhje bordi i drejtorëve vendosi që, bazuar në nenin 7, paragrafin 7.1 të marrëveshjes së shitblerjes për diferencën e mospërmbushjes së zotimeve në

vlerë prej 9 441 768.83 eurosh, ndërmarrja e re 'Sharrcem' të paguajë si çmim shtesë për blerjen e aksioneve. Po ashtu, bordi i drejtorëve ka marrë vendim që për ndërmarrjet të cilave u janë tërhequr aksionet 'Grand Hotel' Prishtinë; 'MIM' Golesh dhe 'XIM' Strezoc të ndiqen hapat ligjorë për inkasimin e këtyre ndëshkimeve", është thënë në njoftimin e AKP-së.



KMDLNj-ja: KEDS-i dhe ZRrE-ja janë shndërruar në ankth për qytetarët



EPOKA ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar për ngritjen e çmimit të rrymës. Ky këshill ka thënë se Shërbimi i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) është i përjashtuar nga çdo kontroll dhe se me ndihmën e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) është duke ndryshuar çmimin e energjisë elektrike. "Për shkak të ngritjes

së çmimit të naftës për 6 apo 7 centë, francezët për ditë të tëra po protestojnë në Francë dhe qytete të tjera, me ç'rast policia franceze po përdor gaz lotsjellës, topa me ujë dhe mjete të tjera për menaxhimin e protestave, kurse protestuesit po ngrenë barrikada në vendet ku po protestojnë. Deri më tani janë dy protestues që kanë humbur jetën dhe më shumë se 600 protestues dhe policë të lënduar rëndë dhe lehtë. Në Kosovë KEDS-i, i përjashtuar nga çdo kontroll dhe skajshmërisht i

papërgjegjshëm, me ndihmën e aleatit tradicional, ZRrE-së, e cila do të duhej ta mbrojtë interesin e konsumatorit, kur t'i teket e ndryshon çmimin e energjisë elektrike, i cakton tarifën ku zakonisht të humbur dalin qytetarët, kurse fituesi, KEDS-i, i fryn faturat sa të dojë, duke i kamufluar me ndryshim të tarifave dhe pozicioneve", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Në këtë kontekst, KMDLNj-ja ka vlerësuar se këto tarifa janë duke shkaktuar situata të paqarta te

qytetarët, duke i detyruar ata për vite të tëra të paguajnë për rrymën e pashpenzuar, të cilën e kanë shpenzuar serbët, të cilët nuk e kanë paguar e as që e paguajnë as tani. Pavarësisht prej kësaj, KMDLNj-ja ka thënë se Qeveria nuk e ka marrë asnjë veprim që do ta detyronte KEDS-in dhe ZRrE-në t'i kompensojë në mënyrë retroaktive konsumatorët e plaçkitur. KMDLNj-ja ka theksuar se protestat paqësore janë mjet i lejuar demokratik për sensibilizimin e opinionit, komisioneve

parlamentare, Qeverisë që të jenë më efikas për ta mbrojtur interesin e qytetarit, konsumatorit ndaj arbitraritetit, papërgjegjësisë dhe arrogancës së KEDS-it dhe ZRrE-së, që janë shndërruar në ankth për qytetarët. "Me këto veprime të KEDS-it, ZRrE-së ndaj qytetarit, konsumatorit po bëhen shkelje flagrante të drejtave të njeriut e që po mbesin të paadresuara shkak se nuk po gjejnë përgjigje të merituar dhe mbrojtje nga këto shkelje", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Ministri Beqaj merr pjesë në Samitin e Nëntë të Bosforit në Stamboll



PRISHTINË, 26 NËNTOR - Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrjes, Besim Beqaj, më 27 dhe 28 nëntor do të marrë pjesë në Samitin e Nëntë të Bosforit që mbahet në Stamboll të


Turqisë. Ky Samit mbahet nën përkujdesjen e Presidencës së Republikës së Turqisë dhe organizohet nga "Platforma e Bashkëpunimit Ndërkombëtar" (International Cooperation

Platform-ICP).

Tema e Samitit të nëntë të Bosforit është "Paqe dhe zhvillim i qëndrueshëm për të gjithë". Ministri Besim Beqaj në këtë ngjarje do ta prezantojë Kosovën në panelin

"Liderët e rinj", ku do të flasë për mundësitë dhe përparësitë e Kosovës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, bazuar në potencialin në fushën e inovacionit dhe ndërmarrjes.

Taksa prej 100 përqindësh për mallrat nga Serbia dhe Bosnja nuk është reciprocitet, mirëpo duhet të përkrahjet



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Asgjë e re, asgjë e papritur: Qeveria e Kosovës fillimisht vendosi taksën prej 10 përqindësh për mallrat nga Serbia dhe Bosnja dhe ky vendim nxiti reagime, së pari nga Serbia dhe kolonia e saj ekonomike dhe politike, Bosnja, për të vazhduar pastaj me Brukselin i cili thirrej në marrëveshjen e CEFTA-së e që në këtë rast doli se nuk është shkelur fare. Edhe disa biznesmenë "kosovarë" që e ngritën piramidën e tyre financiare duke bashkëpunuar me tajkunët serbë si puna e Mishkoviçit, reaganu disi me turp, pa u përcaktuar qartë dhe prerë. Opozita kosovare, përkatësisht LDK-ja, duke shfrytëzuar presionin e madh ndaj Qeverisë dhe kryeministrit Haradinaj, deklaroi se mund ta rrëzojë Qeverinë edhe me Listën Serbe e cila u rreshtua, si çdoherë 100 për qind, në anën e Serbisë. Ky veprim i opozitës, një pjesë të saj ishte shumë i pamoralshëm, në çdo aspekt.

Kur u caktua taksa për këto mallra prej 10 përqindësh, kryeministri Haradinaj paralajmëroi që kjo taksë mund të rritej dhe se mund të ndërmerren masa të tjera e që shumica nuk i morën shumë seriozisht, duke besuar se do t'i nënshtrohet presionit, sidomos të ndërkombëtarëve, sikur që do t'i nënshtrohej shantazhit të Lista Srpska që kërcënoi se, në bashkëpunim me opozitën, do ta rrëzojnë Qeverinë Haradinaj mirëpo, për fat të mirë, nuk dolën këto parashikime. Qeveria e Kosovës erri këtu taksë në 100 për qind dhe ndërmori disa veprime tekniko-politike për t'i eliminuar të gjitha mallrat e ku shkruhej "Kosovo i Metohija". Reagimi i Serbisë ishte i pritur, ashtu edhe i Bosnjës, por nuk ishte prituri reagimi aq acarues dhe kërcënues, deri në shantazhim të Frederika Mogerinit dhe Johanes Han, që si nivel jövendimarrës për liberalizim të vizave një kohë të gjatë mashtruan qytetarët e Kosovës, duke thënë se janë plotësuar të gjitha kushtet teknike, kurse tani po del se janë mashtrues ordinerë dhe karrieristë të bindur. Pati edhe reagime të ambasadave të disa shteteve e që lirisht mund të konsiderohet si ndërhyrje në punë të brendshme të Kosovës, aq më parë që edhe shtetet e tyre vendosin taksa ndaj shteteve të tjera, sikur për mbrojtje të prodhimeve të vendit ashtu edhe për mbrojtje të

interesave politike. Shumica e mekanizmave joqeveritarë dhe jopolitikë përkrahën vendimin e Qeverisë dhe kryeministrit Haradinaj e që u bë mirë. Presidenti Thaçi, në mungesë të kohës sepse është shumë i zënë me përpjekjet për bashkim të Luginës së Preshevës, nuk u deklarua për 100 për qind, ndërsa nuk u pajtua për 10 për qind. Sot, në një analizë të shkëlqyer të Augustin Palokaj nga Brukseli për lojërat rreth njohjeve, çnjohjeve, bisedimeve me Serbinë dhe mosliberalizimin e vizave, u bë e qartë se kryeparlamentari Veseli ka përkrahur taksën prej 100 përqindësh për mallrat nga Serbia dhe Bosnja dhe, nëse është e vërtetë, po del shumë konstruktive kjo përkrahje. Kjo përkrahje duhet të forcohet, duhet të zgjerohet dhe duhet të shndërrohet në ndërgjegje dhe vetëdije njerëzore, kombëtare, shtetërore, ekonomike, politike dhe ekzistenciale. Pas këtij vendimi të Qeverisë së Kosovës, LDK-ja doli me një qëndrim se qenka bërë për pazare dhe përfitim politik, duke harruar se, përjashtuar babanë politik dhe ushtarak të shqiptarëve, Hasan Prishtina dhe të pavdekshmin bacë Adem Demaçi, shumica e politikanëve kanë punuar për përfitime politike. Idealizmi në politikë është shkatërrues për karriera politike dhe jo rrallëherë përfundon edhe tragjikisht. Si të komentohet që në kohët më të vështira nëpër të cilat po kalon Kosova, LDK-ja flet vetëm për zgjedhje të parakohshme dhe marrje të pushtetit, në çdo takim, në çdo prononcim, madje edhe kur shkon në xhami në falje të namazit. LDK-ja gjithmonë ka pasur mungesë të idealizmit dhe mungesë të sakrificës, prandaj ka bërë përpjekje ta materializojë sakrificën e të tjerëve. Ashtu vepron edhe sot duke bërë përpjekje ta përvetësojë luftën çlirimtare të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës e të cilën kanë dashur ta zëvendësojnë me dezertorët e një formacioni ushtarak që nuk e ka shkrepur asnjë plumb të vetëm. Idealistët e LDK-së kanë luftuar nën uniformë të UÇK-së dhe me atë uniformë kanë shkuar në amshim, përjetësi, duke u shndërruar në meteorë të lirisë dhe duke ua ndriçuar rrugën e lirisë brezave të ardhshëm. Ata janë dëshmorë të UÇK-së dhe heronj të Kosovës dhe popullit shqiptar e jo dezertorët që ikën nga lufta, që nuk luftuan kurrë, që vdiqën aksidentalisht, kurse politika e kompromisit dhe tyxharëve i shpalli heronj të Kosovës.

Të përkrahjet vendimi për rritje 100 për qind të taksave: Kriminelët e Serbisë, nga koha e Millosheviçit e që sot janë veshur me pushtet, si: Aleksandar Vuçiq, Ivica Daçiç,

Aleksandar Vulin, Nebojsa Çoviç dhe ata të strukturave paralele kriminale në veri të Kosovës, e që mbahet e okupuar nga Serbia, reagan ashtu si edhe mendojnë: Vuçiqi e luan rolin e të moderuarit dhe thërret për hakmarrje civilizuese; Daçiç, si kriminel me pedigree i quan shqiptarët barbarë shkaku se nuk i duam mallrat e tyre; Vulin kërkon intervenim të ushtrisë në mbrojtje të serbëve të Kosovës që kryesisht dhunohen nga vetë Serbia dhe politikanët e tyre, kurse Çoviç kërkon të largohet KFOR-i në mënyrë që Serbia ta përsërisë Prekazin, Mejen, Krushën e Madhe dhe të Vogël, Çirezit, Likoshanin, Abrinë, Poklekun, Studimen dhe masakra të tjera që i ka bërë gjatë luftës në Kosovë. Askush nuk reagoi nga ambasadat e huaja, as shpirtkeqja Mogerini dhe shpirtzi Han. Një i çmendur deklaroi se shqiptarëve ua ndalim ujin nga Ujmani apo i përmbysim duke e hapur digën e këtij liqeni duke i mbytur sikur minjtë. Shoku i Agim Bahtirit, Goran Rakiq, u palos para Vuçiqit në Beograd si një nxënës shumë i dobët dhe, duke qarë kërkoi ndihmë nga kryetari i Serbisë, duke e deligjitimuar kryetarin legjitim të Kosovës, zotni Hashim Thaçin. Me deputetë të Kuvendit të Kosovës nga LS, me ministra dhe zëvendësministra të LS-së, me rob dhe robi, të gjithë u ngrehën kundër Kosovës, kurse marrin paga nga Buxheti i Kosovës e të cilën nuk e ka as shkatërruesi më i madh i tyre dhe ardhmërisë së tyre në Kosovë, Aleksandar Vuçiq. Situatën në Kosovë edhe në ditën e dytë të vendosjes së taksës prej 100 përqindësh e krahasuan me situatën e krizës humanitare në Sudan, Siri, Somali apo me fatin e rohinjave që pamëshirshëm po asgjësohen nga një fituese e Çmimit Nobel për Paqe të shndërruar në Millosheviç të Birmanisë. As për këtë nuk pati reagime nga faktori ndërkombëtar, në ndërkohë, kur Serbia po shkon me hapa galopant drejt integritimit në BE, kurse Kosovës po i premtohet perspektivë evropiane (vetëm gjeografikisht) në ndërkohë që na shtyjnë drejt Turqisë, Sirisë, Libisë, Sudanit, Somalisë, Ganës dhe vendeve të ngjashme të njohura ndërkombëtarisht si shtete me një demokraci shumë të zhvilluar dhe të qëndrueshme. Është shumë e pamoralshme që në këto çaste të flitet për rrëzimin e Qeverisë me ndihmën e Lista Serpska. Qeveria mund të rrëzohet në ndonjë mënyrë tjetër, ndonëse nuk ka rrezik që kjo të ndodhë shpejt. Hashim Thaçi e ka, jo çelësin, por kallauzin për ta rrëzuar Qeverinë kur të dojë dhe si të dojë por, për momentin, nëse e rrëzon qeverinë, Hashimi do të jetë humbësi më i madh. LDK-ja pa dyshim se

ka pasur një epërsi, mirëpo e vuri në bixhoz me qëndrimet e fundit pas vendosjes së taksës prej 100 përqindësh për mallra nga Serbia dhe Bosnja kur po e dëshmon një agresivitet jo në rregull dhe një grykësi të madhe për pushtet për shkak të ndasive të brendshme brenda kësaj partie. Po të mba-heshin zgjedhjet brenda tre (3) muajve dhe nëse Qeveria dhe Ramushi nuk e ulin këtë taksë në 10 për qind me të cilën është pajtuar edhe Vuçiqi, AAK-ja nuk do të fitonte më pak se 13-15 për qind të votave. Nëse dikujt i konvenojnë zgjedhjet në këtë kohë dhe në këtë situatë, ai është Ramush Haradinaj dhe AAK-ja. Prandaj edhe nuk duan ta rrëzojnë Ramushin në këtë kohë dhe këtë nuk e duan as ndërkombëtarët, ndonëse ka pasur qëndrim të paluhatsëm në mbrojtje të taksës prej 100 përqindësh sikur që është kategorik kundër makijazhit të kufijve që po e propozon Sellma politike e Kosovës - Hashim Thaçi. Por, edhe nëse ndodh që kjo masë të pezullohet për arsye të ndryshme apo premtimeve nga miqtë ndërkombëtarë, kjo gjendje kurrë më nuk do të kthehet në pikën zero, me Ramushin kryeministër apo me dikë tjetër. Është thyer ose është çarë mosguximi për kundërshtim, pushkën e kundërshtimit mund ta mbushim edhe me municion të kalibrit që e kërkon interesi kombëtar dhe interesi shtetëror. Bosnja ka deklaruar se kjo taksë ia rrezikon 10 000 vende të punës dhe në bazë të kësaj llogarie del se Serbisë i rrezikohen së paku 50 000 vende të punës e që nënkupton se Kosova mund t'i hapë së paku 35-40 000 vende të punës. Në fund të fundit, nuk e kemi fare detyrim të blejmë mallra nga Bosnja dhe Serbia kur ato bëjnë përpjekje ta riciklojnë krimin ndaj shqiptarëve që kanë kryer gjatë viteve 1998-'99 sikur edhe gjatë periudhës 100-vjeçare. Nëse për një vallëzim, kryesisht tango (sipas ndërkombëtarëve), duhen së paku dy persona, për normalizim të marrëdhënieve nuk mjaftojnë dy persona, qofshin ata të ndriturit dhe të përndriturit, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq. Po dëgjoj kur thuhet se, pavarësisht çfarë marrëveshje do ta nënshkruajë Hashim Thaçi, Kuvendi është ai që me votën e vet mund dhe duhet ta refuzojë marrëveshjen e arritur e që nuk është fare e vërtetë. Ndërkombëtarët duan t'ju fusin në detyrime ndërkombëtare duke nënshkruar marrëveshje pastaj nuk nguten për zbatimin e saj; nëse gjejnë mekanizma që shpejt e votojnë, një punë më pak, nëse jo, përmes zgjedhjeve dhe presioneve "demokratike" krijojnë mekanizma që u duhen, herët a vonë! Dhe, kryesisht, ia arrijnë qëllimit. Kujt i kujtohet sot baronesha

Ashton apo Kuperi, Ahtisari apo Petriqi, Vensi apo Çernomirdini?! Po të mos ishte Hashim Thaçi ai që është dhe i cili, për nevoja personale, i dekoron me nga një znaçkë, rrallë se dikush apo edhe askush nuk do të kujtohej për ta. Ashtu do të ndodhë edhe me Frederika Mogerinin, Johanes Hanin apo bletën Maja (Kocianciq). Kur ish të burgosurit politikë shqiptarë trajtoheshin nga UDB-a që fliste shqip, majkat dhe baballarët, por edhe familjarët e disa këshilltarëve të udhëheqësve më lart kosovarë, anëtarë të ASHAK-ut si dhe bartës të disa posteve me rëndësi të veçantë, i rrihnin për orë të tëra për t'u dëshmuar se janë më udbash se udbashët që flisnin serbisht. Udbashët serbë ishin më gjentilë, të rrihnin një orë, pastaj iu linin në duart e xhelatëve udbashë shqipfolës që ju rrihnin derisa edhe vetë nuk u rrëzonin nga lodhja. Kështu ishte atëherë, ata që na torturonin ndërro-heshin, kurse vetëm ne ishim aty. Edhe ndërkombëtarët do të ndërrohen, kurse marrëveshjet do të mbesin!

Urime festa për të gjithë: 28 nëntori është festë e flamurit kuqez, 29 nëntori është festë e atyre faqezi! 28 nëntori është festë e shqiptarëve dhe Shqipërisë, 29 nëntori është festë e AVNOJ-it dhe Jugosllavisë. Urime për të gjithë, pavarësisht ku e gjejnë veten. Në Kosovë ka më shumë që e festojnë 29 nëntorin se 28 nëntorin, sidomos në institucione. Gëzuar me Ismail Qemalin dhe Josip Broz Titon! Megjithatë, për mua dhe familjen time, nuk ka dilemë: "rreth Flamurit të përbashkuar, me një dëshirë, me një qëllim....". Ju mund ta këndonin lirisht: "Druzhe Tito, mi ti se kunemo, da sa tvoga puta ne skrenemo..." dhe orkestrën si dhe dirigjentin do ta gjeni te një pjesë e LDK-së e cila sot po vuan nga patriotizmi i vonuar demokratik sepse vërtet u ka qëndruar besnike mësimëve të Titos. Me fanatizëm madje! Gjet Macolli mund të shpërthejë në lot kur i kujtohet që Titon e ka parë lakuriq, në mos se edhe ia ka mbajtur bil-bilin!

Psikologu Rama dhe pacientët e tij: Të gjithë ata që nuk pajtohen me bisedimet dhe me Hashim Thaçin dhe të cilët, pa shije dhe pa fakte e përdorin cilësimin tradhtar, "psikologu psikiatrik" Edi Rama i quan budallenj dhe të çmendur, pa iu bërë asnjë test të inteligjencës apo kontroll tjetër. Nuk e kam të qartë nëse Rama është kontrolluar vetë më parë te ndonjë profesionist i fushës përkatëse ndërsa, mendoj se një student i vitit të parë i psikologjisë, me një shikim sipërfaqësor, lehtë mund t'ia ndërrojë rolin Ramës, nga "psikologu - psikiater", në pacient!

Në 50-vjetorin e demonstratës së 27 nëntorit të vitit 1968

Takimi ishte në orën 16:00 pa pesë minuta



Sylejman KRASNIQI

Ishte ditë e ftohtë nëntori. U takuam në orën 12:00 te plepat, prapa ndërtesës së Kuvendit Komunal. Unë dhe Nehati erdhëm në Prishtinë nga miniera e qymyrit të Bellaqevcit (ku punonim që më shumë se një vit) me autobusin zyrtar të Kombinativit, kurse Nuhiu erdhi nga Shkolla e Mesme Ekonomike. Osmanin e gjetëm aty duke na pritur. Pas përshëndetjeve dhe pyetjeve të zakonshme, Nuhiu i tregoi Osmanit se si shkonin punët me organizim në shkollën ekonomike. Ndërsa Osmani na dha detyrë, mua dhe Nehatit, që të shkojmë në Shkollën Normale dhe t'u themi shokëve që mos të vonohen por, menjëherë pas provave që kishin për dramën "Besa" të Sami Frashërit, të cilët po e përgatitnin për ta shfaqur me rastin e 28 nëntorit, të vinin sa më parë në oborrin e Fakultetit Filozofik. Kurse ju të dy, tha Osmani, pasi të pushoni pak, merrni sa më shumë shokë dhe shihemi te vendtubimi.

Me Osman Dumoshin njiheshim nga Shkolla e Mesme Teknike. Ishim e njëjta gjeneratë veçse Osmani mësonte për makineri, kurse unë dhe Nehat Ramadanin për elektroteknikë. Nga shkolla e mesme kishim mbetur shokë të mirë. Të dyja klasat tona bashkëpunonim mes vete. Bile edhe në pushime verore, nëpërmjet Shoqatës së Ferialistëve të Shkollave të Mesme, shkonim në bregdet bashkë. Me Nehat Ramadanin njiheshim nga klasa e parë e shkollës së mesme. Nehati ishte nga Terrnofci i Madh. Që në fillim të vitit shkollor Nehati na u imponua si shok i mirë me sjelljet shembullore.

Me Nehatin shkuam në Shkollën Normale për ta çuar porosinë e Osmanit në vend. Aty i gjetëm duke bërë provat e fundit të dramës "Besa". Përgjegjëse e grupit ishte Sofije Isaku, një shoqe e imja me të cilën ishim në të njëjtën klasë në shkollën fillore. Ajo sikur na e lexoi mendimin se pse kishim shkuar. Na tha se do të jemi në kohën e caktuar në vendin e duhur. Me Nehatin u ndamë në qendër të trekëndëshi. Unë shkova në shtëpi, kurse Nehati në banesë. Kombinati ia kishte ndarë një banesë për beqarë në qendër të qytetit te kompleksi "Avalla". Pas pushimit shkova kah banesa e Nehatit dhe bashkë dolëm për në oborrin e Fakultetit Filozofik. Kur u afroam pranë vendit të tubimit e pamë se masa e madhe e studentëve tashmë kishin dalë në rrugë. Osman Dumoshi me grupin organizativ ishin në rreshtin e parë të demonstruesve, ashtu siç e do rregulli. Kur na pa neve na e bëri me dorë që të futemi edhe ne në atë rresht. Nuk e hetuam se a ishte ky gjest dënimi pse ishim vonuar për disa minuta apo ishte shprehje e

afrisë sonë si shokë dhe gjeneratë? Nuk e kundërshtuam dhe u rreshtuam me të parët. Në atë moment filluam të përleshemi me policinë e cila na e kishte zënë udhën te "Tre Sheshirat". Masa e madhe studentore nuk kishte të ndalur. Fuqishëm defiluam nëpër qendër të qytetit. Shkuam edhe te burgu i Prishtinës me brohoritje për lirinë e Adem Demaçit. Te ndërtesa e "Avallës", e cila ishte pronë e Kombinativit, nga dhomat e katit të tretë (ku banonin serbë dhe malazezë) një plumb e goditi për vdekje të riun Murat Mehmeti nga lagja Tophane. Qendra e qytetit u mbush me demonstrues, por edhe me policë. Nëpër qendër erdhën me shpejtësi edhe disa cisterna me ujë për t'i shpërndarë demonstruesit. Zjarrfikësit, me vrushkuj uji, mundoheshin t'i shpërndanin protestuesit. Një nga zjarrfikësit iu vërsul me vrushkull uji, në atë të ftohtë nëntori, një shokut tonë por, Afrim Loxha si dragua, me shpejtësi rrufeje ia rrëmbeu gypin e ujit dhe e drejtoi nga policët. Protestat nuk kishin të ndalur nëpër rrugët dhe sheshet e Prishtinës. Aty nga ora 19:30 minuta arrita në shtëpi sepse e kisha porosinë nga Osmani që t'i dëgjoja lajmet e para të Radio Prishtinës. Ishte koha kur njerëzit dilnin nga xhamitë ku i kishin "falur taravitë" sepse ishte muaji Ramazan dhe dita e "Lejle Kadërit". Nëse nuk gabohem, ishte ditë e enjte. "Iftari" ishte në orën 16 e 30 minuta, kurse ata që kanë agjëruar kanë hëngër bukë vetëm pas orës 20.00. Sa më kujtohet mua, disa nga shokët që agjëronin deri atëherë me atë ditë janë përshëndetur përgjithmonë me agjërimin dhe me Ramazanin. Lajmi i parë, në Radio Prishtinë, ishte për demonstratat studentore në Prishtinë dhe në disa qytete të Kosovës. Foli vetë drejtori i Radio Prishtinës i cili demonstratat i cilësoi të qeta dhe të padhunshme. Ditën e nesërme, sigurisht me urdhër nga lart, demonstratat u cilësuan ndryshe nga ato që i kishte vlerësuar Radio Prishtina natën e parë.

Të nesërmen e demonstratave, dhe në ditët në vijim, njerëzit merreshin vetëm me vlerësimin dhe gjykimin e protestave të djeshme. Secili gjykonte me shijen e vet. Shumica dërrmuese thoshin se diçka e tillë është dashhtë të ndodhte. Këto ishin demonstratat, protestat, shprehja e paknaqësisë ndaj situatës apo ndonjë formë tjetër e reagimit, të domosdoshme. Ishte hera e parë që në mënyrë të organizuar ngrihëzëri i popullit të pakënaqur me robërinë dhe shfrytëzimin kolonial, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Për rininë e njomë studentore dhe të shkollave të mesme ishte një provim i vështirë, por i dhënë me sukses të plotë. Nga kjo demonstratë u zgjua ndjenja kombëtare dhe u mposht frika për refuzimin e së keqes edhe nga punëtorët. Vetëm disa ditë pas demonstratave pushteti filloi të bëjë propagandë se po ngjallet nacionalizmi dhe irredentizmi shqiptar. Nëpër tubime që i organizonte pushteti nëpër bashkësi lokale ose nëpër kolektive

punuese për t'i dënuar demonstratat filluan ta ngrinin kokën edhe aktivistët partiakë dhe shtetërorë të dënuar ose të denoncuar në Plenumin e Brionëve dy vjet më parë. Ata menduan se u erdhi momenti për ta rehabilituar veten dhe vijën e tyre politike. Mbaj mend kur në një mbledhje të aktivitetit politik të ish-KXEMK-së (Kombinati Xehetar Energjetik Metalurgjik e Kimik), tani KEK-u, e cila u mbajt në sallën e Drejtorisë së atëherëshme të Kombinativit (në të njëjtën sallë ku ishte Slobodan Millosheviqi njëzetë vjet më vonë) gjarpinjtë e Rankoviçit tentuan ta rehabilitojnë kohën e deformimeve dhe të torturave ndaj shqiptarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Aleksandër Rankoviçit.

Më kujtohet rasti kur, duke hyrë në sallën e mbledhjes, në korridor u takova me mësuesin tim të paharruar nga shkolla fillore, të ndjerin Ismail Dumoshi, i cili, kur më pa mua, më ndali në një qoshe të korridorit dhe më tha turqisht: "Sen syleme hiq bishe", që dmth. "ti mos e merr fjalën fare". Porosinë e mora seriozisht, por nuk e kuptova arsyen se pse më kufizoi në diskutim. Ndër të tjerë, e mori fjalën edhe Nexhmedin Kuçi, ish-shef për kadro në kombinat. Ai, duke vështruar në sallë nga rreshti në rresht, tha se këtu, në këtë sallë, unë po shoh fytyra që i kam parë atë ditë në demonstratë.

Unë, nga frika se e ka me mua, fillova të strukesha mbas kokave të njerëzve të rreshtit para meje. Pas përfundimit të diskutimit të tij e mori fjalën Ismail Dumoshi i cili, pa ngurrim, e bëri një dialog të ashpër me Nexhmedinin. "Nga i ke parë ti ato fytyra në demonstratë, shoku Nexhmedin", e pyeti Ismaili? "Isha në mesin e demonstruesve dhe i kam parë nga afër e mua syri nuk më rren", ia ktheu me nervozizëm Nexhmedini.

"Pra, shoku Nexhmedin, edhe ti paske qenë pjesëmarrës, a?" "Jo, unë kam qenë me detyrë", ia ktheu tjetri me rrëmbim. "Por, ndoshta, edhe ai që e ke parë ti ka pasur ndonjë detyrë në mesin e demonstruesve?" Vetëm pas dy dite e zëbërtheva dialogun e mbledhjes. Kishte qenë përpjekje për t'i denoncuar Ismail Dumoshin dhe Hysen Rakovicën (të ndjerin) si pjesëmarrës në demonstratë dhe eliminimin e tyre nga procesi i arsimit në shkollën e mesme e cila prodhonte kadro mjeshtërie për nevoja të Kombinativit, por edhe edukonte breza të cilët pastaj i detyronin edhe ekskavatorët gjigantë të flisnin dhe të punonin vetëm shqip. Nga kjo përpjekje doli edhe një e vërtetë tjetër: se Ismail Dumoshi dhe shokëve që e rrethonin pushteti i atëherëshëm nuk ua kishte besën. Nga fundi i muajit dhjetor të po atij viti u mbajt një mbledhje e LKJ-së për anëtarë të ish-Kombinativit në të cilën mori pjesë Veli Deva (kryetar i Komitetit Krahinor të LKJ-së). Mbledhja u mbajt në sallën e madhe të shtëpisë së Armatës e cila ishte pranë hotelit "Grand". Synimi ishte që të njoftohen anëtarësia, por edhe populli, se rreziku nga përsërit-

ja e turbullirave kishte kaluar dhe se tashmë ishte "mundur" armiku. Në tubim u paraqitën me fjalime edhe dy-tre pjesëtarë të Ministrisë së Brendshme të kohës së Rankoviçit të cilët ishin nga Kastrioti dhe deshën ta alarmojnë partinë për "lëshimet" që u janë bërë shqiptarëve dhe se shqiptarët e keqpërdorën "mirësinë" e Serbisë dhe të Jugosllavisë. Pas këtyre e mori fjalën Veli Deva. Porsa doli te katedra, e nxori revolen nga brezi dhe e vuri në foltore. Në mes të tjerash më kanë mbetur në kujtesë përafërsisht këto fjali: "Deformimet që janë bërë në kohën e Rankoviçit nuk mund të rehabilitohen kurrë. Ti, Stevë Gullani, por edhe shokët e tu, mos mbani shpresa se ka ardhur koha për rivlerësim të tyre deformimeve. A e dini ju, iu drejtua sallës, se situata është shumë serioze. Ne po mundohemi që ta mbajmë situatën nën kontroll e dikush këtu, në mesin tonë, dhe u drejtua nga parafolesia, mundohet që të hedhë vaj në zjarr. A e dini ju se në paktin NATO stërvitjet ushtarake tani po mbahen në gjuhën shqipe dhe se emigracioni shqiptar (pra ballistët) kanë lëshuar thirrjen se të gjithë shqiptarët, kudo që janë nëpër botë, të vijnë sa më shpejt në Evropë, dhe mundësisht sa më afër Ballkanit". Pas fjalës së Veli Devës situata u qetësua, por disi të pranishmit mbetën të hutuar dhe gojëhapur nga ato që iu dëgjuan veshët. Duke dalë nga salla shokët, mes vete, pyetenin a dëgjoje edhe ti se çka tha Veli Deva apo më bënë veshët? Çka ka të bëjë me ne pakti NATO? Pse atje bëhen stërvitjet në gjuhën shqipe? A janë të gjitha këto në dobi tonë apo janë vetëm skenarë për interesa të Fuqive të Mëdha? Mos kjo ka të bëjë edhe me daljen e Shqipërisë nga pakti i Varshavës? Ku jemi ne në këtë mes? Dy-tri javë pas demonstratave studentore filloi një fushatë e anëtarësimeve në parti. Qëllimi ishte që të rinjtë të angazhoheshin në parti dhe në aktivitetet partiakë në mënyrë që mos të binin dhe mos të mbeteshin në duar të "irridentës". Në minierën e qymyrit të Bellaqevcit u propozuan disa punëtorë të ri për anëtarësim. Dy nga të propozuarit ishin pjesëmarrës të demonstratës së 27 nëntorit. Në tubimin ku u bënë propozimet për anëtarësim ishte edhe një serb nga Vojvodina i cili kishte ardhur në Prishtinë si kolon para LDB-re. Ai, me të dëgjuar emrat e këtyre dy të propozuarve, tha se "nëse këta të dy pranohen në parti, unë demonstrativisht do ta dorëzoj librezën e partisë sepse nuk mund të rri në të njëjtën parti me irridentët dhe po flitet dhe dyshohet që ata edhe janë pjesëmarrës në demonstratë". Me të dëgjuar këto fjali drejtori i minierës, Sami Kusari (tani i ndjerë), iu drejtua Lubomir Avramoviçit (kolonit nga Vojvodina) se "nëse kjo që thua ti është e vërtetë, rastin paraqite në polici por, mendoje mirë se, nëse nuk ke argumente, do të kesh telashe. Unë e di se ti me disa shokë, sa kam qenë unë në udhëtim zyrtar, keni bërë lista me demonstrues të mundshëm nga punëtorët e

minierës sonë në përpjekje për njollosjen e kuadrove të reja shqiptare. Bile keni thënë se edhe drejtori ynë është burgosur si demonstrues, edhe pse e keni qenë në dijeni se unë isha në udhëtim zyrtar në Gjermani dhe për atë shkak kam munguar në punë për disa ditë. Nga ky shkak kam bindjen se këto që i thua ti dhe i thonë të tjerët janë vetëm trillime. Në parti nuk do të mbahet askush me dhunë, por as nuk do të mundeni ta pengoni zgjerimin me anëtarë të ri sepse partia ka nevojë për freskim. E për shpifjet që i bën ti ndaj kuadrove të reja në parti, ato e kanë zanafillën tek puna e palodhshme e tyre në minierë. Ty, dhe shokëve të tu, ata po ju pengojnë vetëm pse po shkruajnë shqip dhe po e shfrytëzojnë një të drejtë kushtetuese që, edhe po të duam ne, nuk mund t'ju ndalim. Mbete i befasuar me drejtorin e ri të minierës i cili nuk lejoi të njollosen teknikët e ri dhe ua hapi rrugën entuziastëve për punë dhe veprim. Më vonë e kuptova se drejtori im, Sami Kusari, dhe mësuesi im i shkollës fillore, Ismail Dumoshi, ishin shokë të pandashëm dhe se e kishin marrë për detyrim që Kombinatin, me patjetër, ta kthenin për së mbari. Për ngjarjet të cilat kanë lënë gjurmë në histori ose i kanë shpejtuar proceset shoqërore duhet të shkruhet dhe të zëbërthehen. Edhe për 27 Nëntorin e vitit 1968 në Prishtinë dhe në shumicën e qyteteve të Kosovës, duke përfshirë këtu edhe qytetet shqiptare në Maqedoni, sepse edhe ato dikur Kosovë ishin, është shkruar dhe do të shkruhet përherë. Kësaj here u mundova t'i shënojë në letër ngjarjet dhe pasojat që sollën ato demonstrata në një segment të vogël të industrisë së Kosovës si përjetues i atyre ndodhive. Por edhe punëtorët e Kosovës, secila në mënyrën e vet, kanë dhënë mjaft në çdo etapë të zhvillimeve pozitive për kombin. Natyrisht se në këto kontribute rol të madh kanë pasur edhe individët e caktuar dhe në kohën e caktuar. Rol të pamohueshëm për përgatitjen dhe drejtimin e fuqisë pozitive të punëtorëve të Kombinativit-KEK-ut, para dhe pas demonstratave të 1968-s, ka pasur Ismail Dumoshi, Sami Kusari dhe gjenerata e organizatorëve të demonstratave të 27 nëntorit, si: Afrim Loxha, Nehat Ramadanin (tani të ndjerët), Iliaz Pireva etj. të cilët në atë kohë punuan dhe vepruan në Kombinativ. Puna dhe munda i tyre ishte dhe mbeti forcë shtytëse dhe busollë orientuese deri në rikupimin e egër fashist serb me futjen e masa të dhunshme në shtator të vitit 1990. Masat e dhunshme ishin "dhuratë" e punëtorisë së Kombinativit të atëherëshëm sepse vetë kreu i masave të dhunshme, Petar Kostiqi, në një mbledhje të drejtorisë së dhunshme tha se "masat u futën pasi nuk patëm mundësi ta thyejmë kursesi këtë punëtorë të rebeluar". Kjo qëndresë dhe rezistencë e punëtorisë së Kombinativit e ka zanafillën te demonstratat studentore të 27 nëntorit 1968.

(Marrë nga ciklet në përgatitje për botim "50 vjet në demonstratë")

BE-ja dhe Irani zotohen se do t'i përmbahen paktit bërthamor

BRUKSEL, 26 NËNTOR - Bashkimi Evropian dhe Irani shprehën mbështetjen e tyre për marrëveshjen bërthamore të vitit 2015 dhe thanë se do ta mbajnë të gjallë, pavarësisht prej vendimit të presidentit amerikan, Donald Trump, për t'u tërhequr nga pakti. Përpara bisedimeve BE - Iran mbi bashkëpunimin civil bërthamor,

komisionari për energji i BE-së, Arias Canete, tha se marrëveshja është "vendimtare për sigurinë e Evropës, të rajonit dhe të gjithë botës". Ai tha se marrëveshja, që kufizon ambiciet bërthamore të Iranit, është duke funksionuar. "Ne nuk shohim ndonjë alternativë të besueshme paqësore", shtoi Canete.

Nënpresidenti i Iranit, Ali Akbar Salehi, tha se nëse marrëveshja priset, do të ishte shumë keq, situata do të ishte e paparashikueshme. Trumpi ka vendosur të tërhiqet nga marrëveshja e vitit 2015 në muajin maj, duke thënë se ajo nuk e parandalon Iranin që të bëhet fuqi bërthamore.



Tensione të larta ndërmjet Ukrainës dhe Rosisë

Zyrtarët ukrainas thanë se të paktën gjashtë marinare të saj janë plagosur kur Rusia hapi zjarr ndaj dy anijeve të Marinës ukrainase dhe goditi një tjetër të dielën në Detin e Zi dhe kapi anijet, duke pretenduar se ato hynë në mënyrë të paligjshme në ujërat e saj territoriale

MOSKË, 26 NËNTOR - Rusia hapi zjarr ndaj dy anijeve të Marinës ukrainase dhe goditi një tjetër të dielën në Detin e Zi dhe kapi anijet, duke pretenduar se ato hynë në mënyrë të paligjshme në ujërat e saj territoriale. Zyrtarët ukrainas thanë se të paktën gjashtë marinare të saj janë plagosur, ndërsa mohoi pretendimet e Rosisë duke e akuzuar atë për përfshirje në agresion ushtarak.

Ministria e Jashtme e Ukrainës tha se "veprimet e tilla paraqesin rrezik për sigurinë e të gjitha vendeve të Detit të Zi dhe së këndejmi kërkojnë një përgjigje të qartë të komunitetit ndërkombëtar".


Shërbimi Federal rus i Sigurisë (FSB) akuzoi Ukrainën për provokim të qëllimshëm. "Armët u përdorën për t'i ndaluar me forcë anijet ushtarake ukrainase. Për rrjedhojë, të tri anijet e Marinës ukrainase janë kapur në ujërat territoriale ruse në Detin e Zi", thuhet

në një deklaratë të FSB-së. Incidenti i së dielës filloi kur një rimorkiator ukrainas po shoqëronte dy anije të marinës nga porti i Odessas në Detin e Zi për në portin ukrainas në Mariopol, në Detin Azov nëpërmjet ngushticës Kerç.

Ngushtica Kerç është kalimi i vetëm ndërmjet dy deteve.

Një traktat i vitit 2003 i përcaktoi Detin Azov dhe ngushticën Kerç si ujëra të përbashkëta territoriale. Ukraina tha se roja bregdetare ruse goditi dhe dëmtoi rimorkiatorin dhe qëlloi mbi dy anijet dhe i bllokoi ato. Ukraina tha se Rusia përdori një tanker për ta mbyllur ngushticën. Rusia tha se anijet ukrainase shkelën në ujërat e saj territoriale dhe akuzoi Ukrainën se nuk e ka informuar që anijet po planifikonin të lundronin nëpërmjet ngushticës - pohime këto që u hodhën poshtë nga Ukraina.

Presidenti ukrainas Petro Poroshenko mbajti një takim



emergjent të kabinetit të dielën dhe tha se do t'i propozojë parlamentit shpalljen e ligjit të luftës.

Një takim emergjent i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara është mbajtur të hënën pasdite sipas kohës së Evropës Qendrore.

Më herët gjatë këtij viti, administrata e presidentit Donald Trump i kërkoi Rosisë t'i japë fund pengimit të anijeve ndërkombëtare në Detin Azov dhe ngushticën Kerç, që synon dobësimin e ekonomisë së Ukrainës.

Marrëdhëniet midis Rosisë dhe Ukrainës janë përkeqësuar që kur Moska aneksoi Gadishullin e

Krimesë dhe nxiti një konflikt separatist pro-rus në Ukrainën Lindore në vitin 2014. NATO-ja tha se po ndjek nga afër zhvillimet dhe bëri thirrje për përmbytje dhe shtendosje të situatës.

Zëdhënësja e NATO-s, Oana Lungescu, tha se "NATO-ja mbështet fuqishëm sovranitetin dhe tërësinë tokësore të Ukrainës, përfshirë edhe të drejtën e saj për të lundruar në ujërat territoriale. I bëjmë thirrje Rosisë të sigurojë qasje të papenguar në portet ukrainase në Detin Azov, në pajtim me ligjin ndërkombëtar", shkroi ajo. Bashkimi Evropian tha se pret që Rusia ta rivendosë kalimin e lirë në

ngushticën Kerç, ndërsa u bënë thirrje të dyja palëve të veprojnë me vetëpërmbytje dhe ta shtendosin menjëherë situatën.

Në një komunikatë të zyrës së shesës së politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ajo citohet të ketë thënë më herët në Parlamentin Evropian se zhvillimet në Detin Azov janë dëshmi se si jostabiliteti dhe tensionet rriten kur nuk respektohen rregullat themelore të bashkëpunimit ndërkombëtar. Në reagim ritheksohet qëndrimi se BE-ja nuk e ka njohur dhe nuk do ta njohë aneksimin e Krimesë nga Rusia.

Qeveria britanike vazhdon punën për shkëputje nga BE-ja



LONDER, 26 NËNTOR - Kryeministria britanike Theresa May dhe ekipi i saj i ministrave kryesorë ranë dakord t'i vazhdojnë përgatitjet për rrezikun e largimit nga Bashkimi Evropian pa një marrëveshje, tha zëdhënësi i saj. Pas arritjes të një marrëveshjeje për shkëputjen nga Bashkimi Evropian, May përballlet tani

me procesin e vështirë për t'i bindur kritikët e saj dhe për ta kaluar marrëveshjen në Parlament. "Kabineti mbajti një diskutim mbi përgatitjet që po bëhen për t'i dalë përpara mundësisë së rrallë që Britania të largohet pa një marrëveshje, tha zëdhënësi i May pas takimit të kabinetit.

May do të bëjë një deklaratë në

parlament për t'i bindur ligjvënësit ta miratojnë marrëveshjen. Pastaj ajo do të presë në selinë e qeverisë 100 udhëheqës të biznesit britanik, të cilët do t'i informojë mbi rezultatet e arritura me Këshillin e Bashkimit Evropian, ndërkaq që ata do të kenë mundësinë të bëjnë pyetje.

Tërmet në Iran, rreth 600 persona të lënduar

TEHERAN, 26 NËNTOR - Televizioni shtetëror iranian ka thënë se numri i personave të lënduar në tërmetin 6.4 shkallësh që ka goditur pjesën perëndimore të Iranit, ka arritur në 600.

Autoritetet irانية kanë thënë më 26 nëntor se ata janë ende duke tentuar të zbulojnë ndonjë

viktimit si shkak i tërmetit, i cili ka ndodhur në zonën e njëjtë ku ka ndodhur një tërmet një vit më parë, i cili pati rezultuar me më shumë se 600 të vdekur dhe rreth 9 000 të lënduar.

Udhëheqësi i Departamentit iranian për Emergjencë, Pir Hossein Kolivand, i ka thënë

televizionit shtetëror se pjesa më e madhe e personave janë lënduar derisa kanë qenë duke ikur dhe jo si shkak i dëmeve të tërmetit. "Fatmirësisht, tërmeti nuk ka ndodhur në qytete më të mëdha", ka thënë udhëheqësi i Qendrës irانية për Tërmete, Ali Moradi.



Urime 28 Nëntorit



BIRRA
PEJA

Urime 28 Nëntori!

Në ditën e lirisë,
ne flasim më shirë se kurrë.

.ipko

RRETHI YT

**Urime
28 Nëntori,
Dita
Flamurit!**



Kompania e Sigurimeve - Insurance Company

KOSOVA ERE



Urime 28
NËNTORI
Dita e Flamurit

Logos displayed include:
- ABE center
- ABE plus
- ABE Store
- PROGRES PRIZREN
- ABE Industria e Qumështit
- ERABI
- ABE HOTEL
- ABIÇARSHIA



Urime 28 Nëntori



Urime ditëlindjen Bac!



URIME
28 NËNTORI
DITA E FLAMURIT


PESTOVA
www.vipa-ks.com






KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.

PRISHTINA

JUA URON 28 NËNTORIN!



Qendra për Mjekësi Fizikale
dhe Rehabilitim

Nëna Naile

Banja në Kllokot - Kosovë

URIME 28 NËNTORIN!



Tel&Fax: 0280 385 101, 0280 385 555 • Mob: 044 666 006, 045 385 555 • info@nenanaile.com • www.nenanaile.com

Paguaj me Starcard deri në 12 muaj



Urime 28 Nëntori Dita e Flamurit



Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ua uron Festat e Nëntorit

Janet Jackson do të performojë në MAMA 2018



Janet Jackson dominon në të gjithë globin. Ikona e muzikës pop do të shfaqet zyrtarisht në Mnet Asian Music Awards 2018, lajm i cili u bë i ditur përmes rrjeteve sociale. "Ne jemi krenarë të njoftojmë se artistja e

veçantë vjen në MAMA 2018", thuhet në një postim në "Twitter" të bërë nga organizatorët. Ceremonia do të zhvillohet nga 10 dhjetori deri më 14 dhjetor në të gjithë Korenë e Jugut, Japoninë dhe Hong Kong.

John Legend në mbrojtje të Rita Orës



Rita Ora pak ditë më parë kishte mbajtur koncertin që realizohet për ditën e falënderimeve. Në këtë koncert ajo u kryqëzua nga fansat, pasi interpretimi i saj nuk ishte drejtpërdrejt, madje as mimika e buzëve nuk

përputheshin me këngën. Mirëpo këngëtares me prejardhje shqiptare i ka dalë në mbrojtje këngëtari i njohur, John Legend. Ky i fundit kishte thënë se koncerti nuk ka kushte të mjaftueshme dhe kapacitet për ta mbajtur koncertin drejtpërdrejt.



Kim Kardashian: Isha nën ndikimin e ekstazës kur u martova

Kim Kardashiani ka folur rreth të kaluarës së saj. 38-vjeçarja zbuloi disa gjëra interesante në episodin e së dielës në Keeping Up With The Kardashians. Gjatë episodit, Kim ka pranuar se u martua nën ndikimin e ekstazës me Damon

Thomas në vitin 2000. "U martova nën ndikimin e ekstazës herën e parë", ka deklaruar ajo. "Unë piva një herë ekstazi dhe u martova, e bëra përsëri. Bëra një video seksi, sikur shumë gjëra të këqija do të ndodhnin", ka treguar Kim Kardashian.

Dua dhe Bebe nuk ndahen nga njëra-tjetra



Dua Lipa dhe Bebe Rexha kaluan një natë bashkë në Londër. Të dyja u panë duke

dalë nga një restorant pasi hëngrën një darkë bashkë. Ato më pas vazhduan në Soho House.

E jashtëzakonshme

Arkeologët hapin varrin 3000-vjeçar

Mistere të mëtejshme 'të varrosura' në rërën e shkretëtirës së Luginës së Mbretërve në Egjipt janë zbuluar. Tani është zbuluar një varr i ri dhe besohet se fshihet trupin e mumifikuar të një prifti të lashtë dhe gruas së tij. Ministria e Antikiteteve të Egjiptit raportoi se



varri 3000 vjeçar i përket kryepriut Thaw Inkhetlf.

BARSOLETA E DITËS



Biondes së ulur në autobus i afrohet një plakë e cila po qëndronte në këmbë dhe e pyet:
- Oj vajzë e mirë, a mund t'i ndërrojmë vendet?
- Çka, unë të bëhem plakë a?, i përgjigjet biondja.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetem gjate vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.

FOTO E DITES



Vullkani shpërthen në lindjen e diellit në Guatemala. /EPA/

E rrallë

Një çift gjen 7.5 milionë dollarë

Një personi i ka ndodhur të vihet në dilemë në jetën reale. T'i kthejë apo të mos i kthejë 7.5 milionë dollarë që i gjeti në një kasafortë që e bleu për 500 dollarë? Po sigurisht se nuk u shkoi gjithçka siç donin, sepse u kontaktuan menjëherë nga pronari i mëparshëm i depos. Pas shumë diskutimesh, pronari i 7.5 milionëve ofroi t'u linte 600 mijë dollarë, nëse ua kthenin të tjerat.



Negociatat vazhduan derisa shuma shkoi 1.2 milion dollarë.

 <p>DASHI Edhe pse nuk doni, një problem familjar ju shqetëson prej kohësh. Duhet t'i menaxhoni situatat brenda familjes.</p>	 <p>DEMI Ka kohë që dashuria nuk ju ka buzëqeshur. Jeni mësuar me këtë fakt dhe sot do të habiteni nga një propozim i papritur.</p>	 <p>BINJAKËT Familja ka marrë masat që sot gjithë koha e shpenzuar të jetë me ta. Do të ndiheni të mbushur shpirtërisht.</p>	 <p>GAFORRJA Po e shijoni shumë këtë ditë, edhe pse jeni në ambient pune. Keni qetësinë e nevojshme për t'i zgjidhur problemet.</p>	 <p>LUANI Që në orët e para të ditës sot do të merrni një konfirmim që kishit kohë që e prisnit. Kjo do t'ju sjellë shumë në humor.</p>	 <p>VIRGJËRISHA Mëdyshjet që keni lidhur me një person të caktuar sot do t'i shprehni me zë të lartë. Do të shikoni që dhe të tjerët e mendojnë si ju.</p>
 <p>PESHORJA Keni diçka për t'i thënë partnerit, por nuk po gjeni momentin e duhur. Rezervoni një udhëtim veç për ju të dy.</p>	 <p>AKREPI Surprizat gjithmonë ju kanë pëlqyer. Një person afër jush e di këtë gjë dhe sot do t'ju japë një emocion të veçantë.</p>	 <p>SHIGJETARI Nuk ndiheni mirë nga gjendja shpirtërore sot dhe do ta reflektoni këtë gjë edhe në humorin tuaj. Do të keni një zënkë me një familjar.</p>	 <p>BRICJAPI Disa probleme të vogla shëndetësore sot ju kanë shqetësuar disi. Do të këshilloheni me një mjek.</p>	 <p>UJORI Një person ka hyrë përsëri në jetën tuaj nga e kaluara. Ky fakt nuk po ju shqetëson fare, përkundrazi po e shijoni.</p>	 <p>PESHQIT Financat tuaja kanë pasur probleme kohët e fundit. Për këtë arsye keni vendosur t'i shkurtoni shpenzimet.</p>



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.465/18

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, me gjyqtarin Besnik Bislimaj dhe me zyrtaren ligjore Majlinda Bakalli, në çështjen juridike të paditësit Hysen Nezir Ahmeti nga fshati Kralan, Komuna e Gjakovës, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Adem Ademaj nga Gjakova Rr. "Sadik Stavileci" nr 41/A, kundër të paditurësi Helga Born Liedke e vajzërisë Inge Liedke, nga Republika Federale e Gjermanisë, tani me adresë të panjohur, për shkak të shkurorëzimit, me datë 26.09.2018, mori këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurës Helga Born Liedke, Republika Federale e Gjermanisë tani me adresë të panjohur, i **CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm avokatia Shpresa Bakija nga Gjakova.

Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe obligimet e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare, një nga gazetat e përditshme ditore, si dhe tabelën e shpalljeve të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësi Hysen Nezir Ahmeti nga fshati Kralan, Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarit të tij Adem Ademaj nga Gjakova, pranë kësaj gjykate me datë 26.07.2018, ka parashtruar padi për shkak të shkurorëzimit, kundër të paditurës Helga Born Liedke, Republika Federale e Gjermanisë, tani me adresë të panjohur.

Paditësi Hysen Nezir Ahmeti nga fshati Kralan, Komuna e Gjakovës, me rastin e ushtrimit të padisë, ka propozuar gjykatën që ta caktoj përfaqësuesin e përkohshëm për shkak se e paditura është shtetase Gjermane dhe se nuk disponon të dhëna për vendqëndrimin e saj atje.

Duke vendosur sipas propozimit të të autorizuarit të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit të lartë cekur.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

C.nr.465/18 të datës 26.09.2018



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk ankesa, në kuptim të nenit 387.2 të LPK-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Departamenti i administratës - Menaxherja e personelit, lidhur me Konkursin e jashtëm të shpallur me dt. 13.09.2018 në gjuhën shqipe dhe serbe, lëshon këtë:

N J O F T I M
Mbi Anulimin e Konkursit për pozitën:

1. Zyrtar i lartë i regjistratit të popullsisë- 1 (një vend pune)
Numri i Referencës: ASK-DSS-002

Anulimi i këtij Konkursi bëhet duke u bazuar në Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në ASK-se me nr. protokollit 04-052-1954 të dt. 22.11.2018

Nga pjesëmarrësit në Konkurs kërkohet mirëkuptim.

Odeljenje Administracije - Menađer osoblja u vezi javnog Konkursa objavljenog 13.09.2018. godine na Albanskom i Srpskom jeziku objavljuje ovo:

O B A V E Š T E N J E
o Poništavanju Konkursa za poziciju

1. Viši Službenik Registra Stanovništva - 1 (jedno radno mesto)
Referentni broj: ASK-OSS-002

Poništavanje ovog Konkursa se zasniva na Odluku Komisije za Rešavanje Sporova i Žalbi u ASK-u sa brojem protokola 04-052-1954 datuma 22.11.2018.

Tražimo razumevanje od učesnika na konkursu.

Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. "Zemel Salihu" nr. 4 - 10.000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: 038 235 111 xxxx / Faks: 038 235 033 / + 377 (0)44 xxxx xxxx
<http://www.ks-gov.net/esk>, e-mail: esk@ks-gov.net, e-mail: privat

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Mufail Hoxha nga Gadimja-Lipjan, shpallë të pavlefshme diplomën e Fakultetit Filologjik dega Pedagogji Prishtinë.

Arilinda Merovci shpallë të pavlefshme diplomën e drejtimit Laborant të SH.M.M. "Dr. Xheladin Deda" në Mitrovicë.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift në Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë të jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira në Prishtinë, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshohet me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmeri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësorjme me korrektsi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 049-909-641.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshohet banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të vulltshme dhe po ashtu me çmim të vulltshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i vulltshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i vulltshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	CSKA MOSCOW - PLZEN	1	JUVENTUS - VALENCIA	1	MAN UTD - YOUNG BOYS	1
-------------------	---------------------	---	---------------------	---	----------------------	---

Patriot Behrami: Krenari ta fitosh turneun 'Adem Jashari'

Boksieri Patriot Behrami ndihet krenar se ka triumfuar në turneun e boksit "Adem Jashari". "Ky është çmimi më i mirë që e kam marrë në këtë vit sepse ishte viti im i parë që jam në boks senior dhe hera e parë që marr pjesë në këtë turnir kaq të rëndësishëm. Në përzgjedhjen e jurisë u shpalla boksieri më i miri dhe kjo ka domethënie të madhe për faktin se i kushtohet një njeriu që ka dhënë jetën së bashku me shumë familjarë të tij, për lirinë të cilën po e gëzojmë sot. Normalisht se ndihem krenar për këtë çmim dhe do të punoj edhe më shumë që në të ardhmen të kam suksese të reja", ka thënë Patriot Behrami për "Epokën e re"

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 NENTOR - Boksieri Patriot Behrami ka arritur të dalë fitues në turneun e 20 ndërkombëtar "Adem Jashari" në boks. Ky turne jubilar është organizuar nga Federata e Boksit e Kosovës në palestrën "Minatori" në Mitrovicë, kurse pjesëmarrëse ishin dhjetë shtete.

Turneu "Adem Jashari" ishte në kalendarin e garave të Federatës Evropiane të Boksit (EUBC). Boksieri i talentuar, Behrami, ka thënë se ndihet i nderuar që ka arritur të triumfojë në një turne kaq të rëndësishëm. "Ky është çmimi më i mirë që e kam marrë në këtë vit, sepse ishte viti im i parë që jam në boks senior dhe hera e parë që marr pjesë në këtë turnir kaq të rëndësishëm. Në përzgjedhjen e jurisë u shpalla boksieri më i miri dhe kjo ka domethënie të madhe për faktin se i kushtohet një njeriu që ka dhënë jetën së bashku me shumë familjarë për lirinë të cilën e gëzojmë sot. Normalisht se ndihem krenar për këtë çmim dhe do të punoj edhe më shumë që në të ardhmen të kam suksese të reja", ka thënë Patriot Behrami për "Epokën e re".

Boksieri i klubit të Gollakut në finale e mposhti italianin Naser Ricard, në kategorinë deri në 69 kilogramë. "Ndeshja me atë boksier ishte e vështirë, por me përgatitjet që kemi bërë me trajnerët arrita të paraqitem mirë dhe të dal fitimtar. Përballja me



kundërshtar jashtë Kosovës është e mirë për ne boksierët, sepse fitojmë me shumë përvojë për turnet dhe kampionatet ndërkombëtarë", ka shtuar ai.

Boksieri Patriot Behrami ndihet shumë i lumtur që ka një emër të tillë, kurse premtori se do të mundohet që këtë emër ta ngrehë sa më lart, pasi ky emër është mjaft i veçantë për popullin shqiptar. "Ndjenjë e mirë që dola fitues

në turneun për komandantin tonë legjendar dhe ndjenjë e mirë për mua që quhem Patriot, ani pse jam i lindur pas përfundimit të luftës në Kosovë. Do të përpiqem ta ngreh sa më lart këtë emër, sepse është shumë i veçantë për të gjithë shqiptarët", ka shtuar ai. "Nuk do të ndalem së përgatituri që në një të ardhme të afërt të fitoj medalje në kampionate evropiane dhe botërore", ka përfunduar Behrami.

SHKURT

Ponte Prizreni dhe Jaquan Smith ndajnë rrugët

Basketbollisti amerikan Jaquan Smith nuk është më pjesë e skuadrës së Ponte Prizrenit. Lajmin e ka konfirmuar vetë skuadra prizrenase në faqen zyrtare në "Facebook". "Nga sot zyrtarisht klubi ynë dhe lojtari amerikan alo qendra Jaquan Smith kanë ndarë rrugët me marrëveshje të dyanshme. Lojtari në fjalë, sipas të gjitha gjasave, karrierën do të vazhdojë në kampionatin e Shqipërisë. Ne falënderojmë Jaquanin për kontributin e dhënë dhe i dëshirojmë suksese në të ardhmen", thuhet në njoftimin e Ponte Prizreni.

Shaqiri, City: Deri në fund luftojmë për titull

Futbollisti shqiptar i Liverpoolit, Xherdan Shaqiri, ka thënë se ata do të luftojnë deri në fund për titullin e Premierligës. "Ne do të jemi deri në fund për titull. Ne nuk duhet ta shikojmë Manchester Cityn, ne duhet ta shikojmë vetëm veten dhe të mundohemi të japim më të mirën nga vetja. Çdo ndeshje e ka historinë e vet dhe ne shikojmë ndeshje për ndeshje se ku qëndrojmë në fund të sezonit. Nëse ju fitoni ndeshje si këto, atëherë ju do të luftoni deri në fund, të vazhdoni të punoni dhe të fitoni ndeshje të vështira", ka thënë Shaqiri.

Wengeri, trajner i Bayernit?

Arsene Wengeri mund të emërohet para muajit janar trajner i ri i Bayern Munchenit. Në fakt, drejtuesit e Bayernit janë të pakënaqur me punën e Niko Kovaçit dhe janë shumë afër ta shkarkojnë trajnerin kroat, pasi skuadra "bavareze" është e pesta në tabelë me nëntë pikë pas Borussia Dortmundit. Wengeri gjatë verës u largua nga Arsenali dhe mediet gjermane bëjnë me dije se negociatat në mes të trajnerit francez dhe drejtuesve të Bayernit kanë filluar.

Berisha: Do të paraqitemi mirë ndaj Rumanisë dhe Maqedonisë

Prishtinë, 26 nëntor - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll më 29 nëntor do të përballlet me Rumaninë në qytetin Oradea, kurse më 2 dhjetor në Gjevgjeli do të ballafaqohet me Maqedoninë. Kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha, është optimist se Kosova do të ketë paraqitje të mira në këto ndeshje që janë të

vlefshme për parakualifikimet evropiane për "Eurobasket 2021". "Kemi filluar përgatitjet, ndërsa po presim të na bashkohen edhe basketbollistët tjerë. Atmosfera është shumë e mirë. Sigurisht se të gjithë do ta japim maksimumin tonë dhe shpresojmë të paraqitemi sa më mirë në këto ndeshje shumë të rëndë-

sishme", ka thënë Berisha. Fituesi i këtij grupi do të kualifikohet në kualifikime për "Eurobasket 2021" që do të fillojnë në nëntor të vitit të ardhshëm, kurse dy skuadrat e tjera e kanë edhe një shans tjetër për t'u kualifikuar, por nëpërmjet një raundi shtesë që do të luhet në gusht të vitit 2019.



Vëllezërit Avdylaj priten nga kryetari Haki Rugova

ISTOG, 26 NENTOR - Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, ka pritur në takim kikkoksierët shqiptarë Dardan dhe Hekuran Avdylaj të cilët jetojnë dhe veprojnë në Austri. Gjatë këtij takimi kik-

boksierët e njoftuan kryetarin Rugova me të arriturat e tyre gjatë kësaj periudhe si dhe me synimet që ata kanë për të ardhmen. Vëllezërit Avdylaj janë kampionë në kikkoks në kategorinë e mesme dhe të

rëndë në Austri si dhe synim i tyre është shpallja kampion evropian dhe botëror. Kryetari Rugova falënderoi për vizitën kikkoksierët si dhe u uroi për sukseset e arritura deri më tani dhe në vazhdimësi. Me

këtë rast, kryetari Rugova shprehi gatishmërinë për përkrahjen e tyre në të ardhmen. Duke pasur parasysh interesimin e këtij sporti në Kosovë gjatë takimit u diskutua edhe për mundës-



inë e mbajtjes së një turniri të kikkoksit në Istog.

Liga e Kampionëve rikthehet me derbin Roma - Real



ROME, 26 NENTOR (ER) - Liga e Kampionëve rikthehet me derbin që zhvillohet në "Olimpico" në mes të Romës dhe Real Madridit. Këto dy skuadra përballen në kuadër të Grupit G. Synimi i tyre është fitorja për ta marrë kryesimin që aktualisht mbahet nga Reali me nëntë pikë, aq sa ka edhe Roma në pozitën e dytë. Të dyja këto skuadra kanë zhgënjyer në fundjavë duke pësuar humbje në kampionatet përkatëse. Fillimisht Reali pësoi humbje nga Eibari me rezultat 3-0, kurse Roma pësoi humbje nga Udinese e Valon Behramit me rezultat 1-0. Skuadra e drejtuar nga Santiago Solarit dëshiron të

bëjë një shfaqje të madhe në "Stadio Olimpico" dhe ta sigurojë pozitën e parë në grup. Reali në këtë ndeshje do të jetë pa brazilianin Casemiro dhe Nacho Fernandez, kurse Dani Carvajal. Në anën tjetër mungesat e Romës janë Daniele De Rossi dhe Diego Perrotti, kurse mbrojtësi Kostas Manolas është në dyshim. Sulmuesi Edin Dzeko duhet të kthehet në njëmbëdhjetëshe, pas lojës kundër Udineses që ishte në bankën rezervë. Reali e fitoi ndeshjen e parë në Spanjë me rezultat 3-0, kurse Roma në tri ndeshjet e tjera arriti tri fitore duke e konfirmuar kandidaturën për pozitën e parë.

GRUPI E		
18:55	AEK Athens - Ajax	
21:00	Bayern Munchen - Benfica	
TABELA		
1. Bayern Munchen	4	10
2. Ajax	4	8
3. Benfica	4	4
4. Aek Athens	4	0
GRUPI F		
21:00	Hoffenheim - Shakhtar Donetsk	
21:00	Lyon - Manchester City	
TABELA		
1. Manchester City	4	9
2. Lyon	4	6
3. Hoffenheim	4	3
4. Shakhtar Donetsk	4	2
GRUPI G		
18:55	CSKA Moscow - Viktoria Plzen	
21:00	Roma - Real Madrid	
TABELA		
1. Real Madrid	4	9
2. Roma	4	9
3. CSKA Moscow	4	4
4. Viktoria Plzen	4	1
GRUPI H		
21:00	Juventus - Valencia	
21:00	Manchester United - Young Boys	
TABELA		
1. Juventus	4	9
2. Manchester United	4	7
3. Valencia	4	5
4. Young Boys	4	1

Lakersi humb nga Orlando, Toronto mposht Miamin

LOS ANGELES, 26 NENTOR - Vijon sezoni me luhatje i skuadrës së Lakersit, që u mund 108-104 në fushën e vet nga Orlando. Një ndeshje me dy pamje, e mirë për kalifornianët në pjesën e parë, me LeBron Jamesin që realizoi 24 pikë. Në të dytën erdhi përmbysja e miqve, me Vuçeviqin që realizoi 31 pikë e 15 rebounde, ndërkohë që 42 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit. Fitore të lehtë korri Utah Jazz, që mundi 133-112 Sacramenton, sfidë e komanduar nga miqtë, me 6 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë (Rubio 27 pikë). Në Lindje vijon të komandojë skuadra e Torontos, që mundi 125-115 Miamin, ndeshje e dominuar nga basketbollistët e ekipit kanadez. Leonardit me 29 pikë ishte shënuesi më i mirë, mbështetur nga Siakam me 21 (7 lojtarë të Raptorsit realizuan mbi 10



pikë). Fitore në sekondat e fundit korri Atlanta, që mundi 124-123 Charlotten, ku vendimtar me koshin e tij ishte Collins (23 pikë e 11 rebounde). E njëjta situatë edhe në fitoren 127-125 të Philadelphia's ndaj Brooklynit, ku u dalluan Jimmy Butleri me 34 pikë e 12 rebounde e Embiidit me 32 pikë e 12 rebounde.

REZULTATET	
Lakers - Orlando	104-108
Detroit - Phoenix	118-107
Atlanta - Charlotte	124-123
Brooklyn - Philadelphia	125-127
Memphis - New York	98-103
Toronto - Miami	125-115
Sacramento - Utah Jazz	112-133
Portland - Clippers	100-104

SHKURT

FShF-ja shkarkon trajnerët, mbijeton vetëm Bushi

Federata Shqiptare e Futbollit vendos të ndryshojë thujtë të gjithë trajnerët e ekipeve kombëtare të moshave. I vetmi i konfirmuar, me sa duket, do të jetë Alban Bushi, trajneri i Kombëtares U21, ndërkohë që do të ndryshohen të gjithë trajnerët e ekipeve të tjera. Largohet Ejon Bogdani nga ekipi kombëtar U19, për t'u zëvendësuar nga Nevil Dede; largohet Xhemal Mustedanagiq si trajner i kombëtares U17, i cili ka marrë postin e drejtorit të ekipeve kombëtare. Në vendin e tij është emëruar Elvin Beqiri, ndërsa Armand Damo ka marrë drejtimin e ekipit U15. Në këtë mënyrë janë ndryshuar të gjithë trajnerët dhe arsyeja ka qenë "rezultatet jo të mira". Trajnerët e sapoemëruar do të jenë me kohë të plotë dhe do të kenë si kusht, shtyrjen e kontratës së tyre në vazhdimësi, kualifikimin në aktivitetet përkatëse. Ende nuk dihen detaje të tjera, pasi prezantimi i tyre do të bëhet ditën e nesërme nga Federata Shqiptare e Futbollit, ku do të mësohet më tepër rreth objektivave dhe ndryshimeve që do të bëhen.

Katër shqiptarë në formacionin e javës në Zvicër

Futbollistët shqiptarë vazhdojnë të shkëlqejnë në kampionatin zviceran. Në formacionin e javës janë plot katër futbollistë shqiptarë. Pjesë e këtij formacioni është mbrojtësi Arlind Ajeti, i cili shkeli në ndeshjen që Grasshoppersi e fitoi ndaj ST Gallenit (2-1). Mesfushori Hekuran Kryeziu shënoi dy gola në barazimin e Zuerich ndaj Xamaxit (3-3). Bastian Toma, po ashtu, ishte vendimtar me golin e tij, duke i dhënë fitoren Sionit ndaj Thunit, kurse Shkëlqim Demhasaj ishte protagonist në barazimin 1-1 që Luzerni arriti me Bazelin, duke dhënë asistimin në golin e shënuar nga Pascal Schurpf.

Iniesta akuzon Mourinhon

Andres Iniesta, i cili aktualisht është lojtar i klubit japonez Viseel Kobe, ka thënë se ishte trajneri Jose Mourinho ai që shkaktoi probleme dhe tensione në mes të Real Madridit dhe Barcelonës. Sipas ish-mesfushorit të Barcelonës, këto tensione shkaktuan dëme në Kombëtaren e Spanjës dhe marrëdhënies mes lojtarëve. "Nuk do të thotë që të jesh fans i Barcelonës ose Real Madridit për ta ditur se situata ishte e pakënaqur. Dhe kryesori për atë situatë ka qenë Mourinho. Nuk ishte rivaliteti siç ka qenë më parë, kalo më tepër, shihje urrejtje. Tensioni në mes të Real Madridit dhe Barcelonës, i shkaktuar nga Mourinho, bëri shumë dëme në Kombëtaren e Spanjës dhe në marrëdhëniet mes lojtarëve", ka thënë Iniesta.

Bayerni interesohet për Sonin

Bayern Munchen vazhdon të jetë skuadër e interesuar për futbollistit e Tottenham Hotspurit, Son Heung-Min. Paraqitjet e sulmuesit kanë bindur drejtuesit e skuadrës gjermane që të hyjnë seriozisht në garë për transferimin e tij. 26-vjeçari ka kontratë me Tottenhamin deri në vitin 2023, por një ofertë e madhe nga Bayerni mund t'i bindte drejtuesit e "Suprsit" të heqin dorë nga shërbimet e tij.

Barça, dy javë pa Suarezin

Barcelona ka treguar se është skuadër që di të fitojë edhe pa "yje", por gjithsesi në rast dëmtimesh përsëri meraku është i madh. I fundit që tremb katalanasit është sulmuesi Luis Suarez, i cili ka pësuar një dëmtim në gjurin e djathtë dhe tashmë do të duhet që të mungojë për dy javë. Suarezit do ta humbasë kështu ndeshjen me PSV-në në Ligën e Kampionëve si dhe ndeshjen me Villareal në La Liga.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Brigada 125"
Komuna: Prizren
Data: 27 Nëntor 2018
Emri i kontratës: Vizitë me nxënës të kl. 0-V Kooptshtit Zoologjik, Stacionit Policor dhe FSK.
Numri i kontratës: ESIP/SDG/83 – CS/1.3

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Brigada 125", Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

- Kompani të udhetimeve (autobus) për realizimin e vizites.

Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm 5 Dhjetor 2018.

Specifikimi i hollësishëm teknik dhe termet e referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-shërbime do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Kontakti: Asim Kastrati
Telefoni: 044 365864
E-maili: sh.f.brigada125@hotmail.com

TENDER**FTESË PËR OFERT**

AGRO PETROL SH.P.K me NRB : 70448037 dhe NRF : 600206024 nga Pestova e Vushtrisë , me qëllim të zbatimit të projektit Ndertimi I fabrikes per perpunimin e patates dhe investimi ne asetet fizike , hap tenderin për ndertimin e fabrikes

32m x 9m x 5m objekti duhet te jetë I ndertuar në bazë te standardeve si dhe makinerit per larje , klasifikim dhe paketim të patates së fresket , poashtu makineria duhet te jetë prodhim I vendeve europiane.

Të interesuarit mund te kerkojnë dokumentet dhe informatat shtes ne lidhje me tenderin në zyren e AGROPETROL SH.P.K nga data 27.11.2018 deri 27.12.2018 ose ne e-mail adresen : agropetroshpk@hotmail.com , ose fizikisht ne zyren tone me adres : Rruga e Shaban Polluzhes nr.12 Pestovë- Vushtrri.

Pra afati I fundit per dorzimin e ofertes së kompletuar është 27.12.2018 .

Oferta juaj duhet te jetë e mbyllur ne zarf dhe e shenuar qartë lidhur me subjektin (qellimin) e lart cekur dhe duhet te dorezohet ne zyren tone.

Oferta duhet te jetë e vulosur dhe e nenshkruar nga personi I autorizuar I kompanisë , si dhe duhet te ketë numrin dhe daten e ofertes.

Ofertes duhet ti bashkangjitet qertifikata e regjistrimit te biznesit (kopje) dhe qertifikata e numrit fiskal (kopje)

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: ShFMU "GRNÇARE" - Grnçare dhe Novo Sello
Komuna: Prizren **Data:** 27 Nëntor 2018
Emri i kontratës: Blerje e kompjuterve (lap top)
Numri i kontratës: ESIP/C1.3/085 - ESIP/SDG/085-G/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU „GRNÇAR“ Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

- Blerje e kompjuterve
Laptop - 4 copa

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën Adresa e Shkolles SHFMU "GRNÇARE" - Grnçare dhe Novo Sello, , Prizren më së largu deri më 06.12. 2018.

4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Adis Mujo
Telefoni: 044 355 049
E-maili: adismujo@hotmail.com

**Shpallet ne likuidim Shoqeria tregtare:
 Drustvo kompanija objavilo je likvidaciju:
 Trades company declared for liquidation:**

Premium Center Shpk

Rr. Xhavit Bajraktari Suhareke

Nr. Biznesit 71282112

Nr Fiskal 601634951



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komuna e Ferizajt
Opština Uroševac - Municipality Ferizaj



Nr. 01/27
Data 26.11.2018

Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L/040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 66, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Ferizajt, nenit 11, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, të Ministrisë së Administratës Publike Komuna e Ferizajt me datën 26.11.2018 publikon:

KONKURS

Titulli i vendit të punës: **Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët**
Drejtoria: **e Arsimit**
Sektori: **i Arsimit**
Niveli profesional
Kodi i vendit punës AR/520
Grada e vendit të punës 9
Koeficienti i tanishëm: 7.00

Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Planifikon të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me zhvillimin e procesit arsimor në institucionet arsimore të komunës;
- Ben identifikimin e nevojave, prioritetëve të institucioneve edukative - arsimore të komunës;
- Bën zbatimin e politikës së MASHT -it në institucionet arsimore të komunës gjegjëse;
- Përgatit propozim rregulloret për funksionimin e shkollës në përputhje me Ligjin e Arsimit parafillor dhe fillor;
- Mbledh të dhënat e nevojshme për shkollat e komunës në nivel përkatës;
- Propozon masat e ndryshme për avancimin e arsimit në përgjithësi;
- Bashkëpunon me MASHT -in, ZRA dhe të gjitha institucionet edukative arsimore në nivelin komunal
- Ben kontrollin dhe mbikqyrjen e të gjitha aktivitetëve nëpër shkollat e komunës së Ferizajt si dhe bën vlersimin e përgjithshëm të procesit edukativ - arsimor në nivelin e arsimit parafillor dhe fillor
- Angazhohet rreth përfshirjes së femijeve të komunitetit RAE në shkollim, duke filluar që nga klasa e parë,
- Angazhohet rreth bashkëpunimit me shkollat e mjedisit,
- Përveç tjerash kyen edhe punet për të drejtat e femijeve si zyrtar i njesise për të drejtat e njeriut
- Kryen edhe punë tjera zyrtare që i cakton drejtori i drejtorisë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huaj të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit: Është e hapur për nëpunës civil ekzistues dhe për kandidatët e jashtëm.

Shkollimi i kërkuar: Universitar - Fakulteti Filozofik – Drejtimi Histori, Pedagogji, Sociologji i, 2 vite përvojë pune

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkojnë:

- Njohja e Kompjuterit – obligative;
- Përvoja e punës - obligative;
- Shkathtësi për të punuar në grup - pune ekipore
- te kete aftesi komunikuese dhe organizative
- të posedojnë shkathtësi dhe aftësi profesionale për të punuar në mënyrë të suksesshme në një shoqëri multi-etnike.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

- Përzgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të caktuar (deri në përfundimin e mandatit dhe kthimit në pozitën paraprake të drejtorit aktual).

Periudha provuese 12 muaj.

Konkursi është hapur prej datës 26.11.2018 deri me datën 10.12.2018.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Komunën e Ferizajt - Qendrën për Shërbime të Qytetarëve.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën, certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime, dhe dëshmi tjera për kualitetet e juaja nëse i posedoni.

Aplikacionet e dërguara me post të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijn brenda dy ditësh ndërsa aplikacionet e arritura pas këtij afatit si dhe aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe të huaj si dhe i mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3, të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranura, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Dokumentet e kandidatëve që aplikojnë pas përfundimit të procedurës së rekrutimit nuk ruhen pasi që nuk janë origjinale.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni Zyrën e Personelit, në këtë numër të telefonit: 038/200/46013

Kryetari i Komunës

Agim Aliu



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komuna e Ferizajt
Opština Uroševac - Municipality Ferizaj



Br. 01/27
Datum 26.11.2018

Na osnovu člana 13 Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03 / L / 040 (Službeni list Republike Kosovo br. 28/2008), član 66. stav 1. Statuta opštine Uroševac, član 11. stav 1. Zakona br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo i članu 5 Uredbe br. 02/2010 o procedurama rekrutiranja u civilnoj službi Republike Kosovo, Ministarstvo Javne Administracije Opština Uroševac 26.11.2018.g. objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: **Službenik za niže srednjoškolsko obrazovanje**

Uprava: **Obrazovanja**
Sektor: **Obrazovanja**
Nivo Profesionalni
Kod radnog mesta AR / 520
Stepen radnog mesta 9
Sadašnji koeficijent: 7.00

Dužnosti i odgovornosti:

- Planira sve aktivnosti vezane za razvoj obrazovnog procesa u obrazovnim ustanovama opštine;
- Identifikuje potrebe i prioritete obrazovnih institucija opštine;
- Implementira politiku MONT-a u obrazovnim institucijama odgovarajuće opštine;
- Priprema nacрте uredbe za funkcionisanje škole u skladu sa Zakonom o predosnovnom i osnovnom obrazovanju;
- Prikuplja neophodne podatke za opštinske škole na odgovarajućem nivou;
- Predlaže razne mere za unapređenje obrazovanja uopšte;
- Saraduje sa MONT-om, ZRA-om i svim obrazovnim institucijama na opštinskom nivou;
- Vrši kontrolu i nadzor nad svim aktivnostima po školama u opštini Uroševac i čini ukupnu ocenu vaspitno - obrazovnog procesa na nivou predškolskog i osnovnog obrazovanja,
- Angažuje se za uključivanje dece RAE u obrazovanje, počev od prvog razreda,
- Angažuje se za saradnju sa školama sredine,
- Pored ostalog, vrši i radove o dečijim pravima kao službenik jedinice za ljudska prava,
- Obavlja i druge službene dužnosti koje određuje direktor uprave.

Uslovi učestvovanja u rekrutiranju:

- U civilnu službu imaju pravo da se zaposle državljani Republike Kosova i odrasli stranci koji imaju potpunu poslovnu sposobnost, poseduju građanska i politička prava, imaju potrebnu edukativnu pripremu i profesionalnu sposobnost za izvršavanje ekzekutivnih zadataka, rukovođe ili administrativne poslove i koji poseduju fizičke veštine potrebne za odgovarajuću poziciju.

Postupak konkurisanja: Otvoren je za postojeće civilne službenike i za spoljne kandidate.

Obavezno obrazovanje: Univerzitet - Filozofski fakultet smer Pedagogija, istorija ili sociologija, edagogija, 2 godine radnog iskustva.

Potrebne veštine, iskustvo i drugi atributi:

- Poznavanje računara - obavezno;
- Radno iskustvo - obavezno;
- Veština rad u grupama - timski rad;
- Imati komunikacijske i organizacione veštine;

- Posedovati veštine i profesionalne sposobnosti za uspešno djelovanje u multietničkom društvu.

Pravni i podzakonski akti koji regulišu rekrutiranje:

- Izbor kandidata vrši se u skladu sa Zakonom br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo i Uredbu br. 02/2010 o procedurama rekrutiranja u državnoj službi.

Trajanje imenovanja: sa određenim rokom (do kraja mandata i vraćanje aktuelnog direktora na prethodnu poziciju).

Probni period 12 meseci.

Konkurs je otvoren od 26.11.2018. do 10.12.2018.

Podnošenje zahteva: Zahtevi se uzimaju i predaju u Opštini Uroševac - Centar za usluge građana.

Aplikacija sadrži kopije dokumentacije o obuci i iskustva, sertifikat iz suda da nisu pod istragom i druge dokaze o svojim kvalitetima, ako imaju.

Prijave poslate poštom koje drže poštanski žig na pošiljci poslednjeg dana roka za prijavu, će se smatrati validnim, i će se uzimati u obzir ako stignu u roku od dva dana, a aplikacije koja stignu nakon isteka roka, bi će odbačene.

"Javna i civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti za zapošljavanje za sve državljane Kosova i aplikacije od svih osoba muškog i ženskog roda iz svih zajednica na Kosovu".

"Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravično i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe centralne i lokalne javne administracije, kao što je navedeno članom 11, stav 3 Zakona br. 03 / L-149 Republike Kosovo".

U slučaju da se primi veliki broj prijave, kontaktirajte se samo kandidati koji su izabrani na užoj listi.

Dokumenti kandidata koji konkurišu, nakon završetka procedure rekrutisanja, ne sačuvaju se, jer nisu originalni.

Za sve dodatne informacije možete se obratiti službi za osoblje, na ovom telefonskom broju: 038/200/46013

Gradonačelnik opštine

Agim Aliu



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i
Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology

Datë : 27.11.2018

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të Ligjit nr. 04/04L për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe në bazë të planit të veprimit të Programit Kombëtar të Shkencës (2010-2015), vazhduar vlefshmëria e PKSHT me Vendim të Ministrit të MASHT, datë : 10.03.2016, ref. nr. 49 / 01B

Shpall:

KONKURS

Për ndarjen e çmimit vjetor

**“Shkencëtar i vitit 2018” dhe
“Shkencëtar i ri i vitit 2018”**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka krijuar një fond për çmime vjetore për rezultate të jashtëzakonshme hulumtuese-shkencore brenda një periudhe njëvjeçare (rezultatet shkencore nga shtatori 2017 deri në tetor 2018). Këto çmime synojnë të promovojnë cilësinë në punën shkencore, të inkurajojnë ngritjen në karrierë dhe shpërblimin e përpjekjeve dhe përkushtimin e hulumtuesve shkencorë të cilët janë në proces të avancimit të diturive të tyre në fushën përkatëse të ekspertizës. Këtë vit do të ndahen 3 (tre) çmime për titullin “Shkencëtar i vitit” dhe 3 (tre) çmime për “Shkencëtar i ri i vitit”.

Kriteret e aplikimit

Mund të aplikojnë shkencëtarët kosovarë të çdo disipline shkencore, të cilët kanë dëshmuar rezultate të larta të punës kërkimore-shkencore. Kandidatët duhet të jenë shtetas të Kosovës dhe duhet të dorëzojnë së paku 3 (tre) rekomandime nga shkencëtarë të tjerë apo institucione kërkimore shkencore, sipas Udhëzuesit për ndarjen e shpërblimit. Kandidati duhet të sjellë një CV dhe një listë lehtë të verifikueshme të botimeve apo të rezultateve shkencore brenda periudhës së përcaktuar.

Financimi që është vënë në dispozicion

Çmimi “Shkencëtar i vitit”, përfshin një shpërblim prej 2000 eurosh për të mbështetur vazhdimin e punës së tyre hulumtuese dhe për të inkurajuar fituesit e çmimit për angazhimin në nisma të reja hulumtuese. Një shkencëtar mund ta fitojë çmimin vetëm njëherë në karrierën e tij shkencore. Për një vit nuk mund të ndahet më shumë se një çmim për një fushë të caktuar shkencore.

Çmimi “Shkencëtar i ri i vitit”, përfshin një shpërblim prej 1500 euro dhe do të jepet në baza vjetore për 3 (tre) shkencëtarët që janë në filllet e para të karrierës kërkimore dhe që kanë dëshmuar rezultate dhe potenciale të larta shkencore dhe hulumtuese.

Konkursi mbetet i hapur 10 ditë nga dita e shpalljes publike në gazeta, në uebfaqen e MASHT dhe mediat elektronike.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në arkivin e MASHT.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data: 10.12.2018 (e hënë).

Aplikacioni një udhëzues me shpjegime dhe kërkesa më të hollësishme për aplikim është i disponueshëm në vegëzën e uebfaqes <http://masht.rks-gov.net/konkurs>.

Aplikimi duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur ku të jetë shkruar: Aplikimi për çmimin “Shkencëtar i vitit” apo “Shkencëtar i ri i vitit” në adresën : Rr. “Agim Ramadani” p. n, 10000 Prishtinë, Kosovo.

Përpos kësaj, një version elektronik i aplikimit duhet të jetë dorëzuar brenda afatit (27 nëntor deri 10 dhjetor 2018, ora 16:00) në adresën: sebahate.jupolli@rks-gov.net në gjuhën shqipe, angleze apo serbe.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i
Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology

Datum : 27.11.2018

Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije, u prilog Zakona br. 04 / 04L o naučno-istraživačkim aktivnostima i na osnovu akcionog plana Nacionalnog programa nauke (2010-2015), nastavak važnosti NNP-a Odlukom ministra MONT-a od datuma 10.03.2016. Ref, br. 49 / 01B

Objavljuje:

KONKURS

Za dodelu godišnje nagrade

**“Naučnik godine 2018” i
“Novi naučnik godine 2018”**

Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije stvorilo je fond za godišnje nagrade za izvanredne istraživačko-naučne rezultate u toku jednogodišnjeg perioda (naučni rezultati od septembra 2017. do oktobra 2018. godine). Ove nagrade imaju za cilj promovisanje kvaliteta u naučnom radu, podsticanje napretka u karijeri i nagrađivanje napora i posvećenosti naučnih istraživača koji su u procesu unapređenja svog znanja u relevantnoj stručnoj oblasti. Ove godine biće dodeljeno 3 (tri) nagrade za "Naučnik godine" i 3 (tri) nagrade za "Novi naučnika godine".

Kritererijumi za apliciranje

Može aplicirati kosovski naučnici bilo koje naučne discipline, koji su dokazali visoke rezultate naučno-istraživačkog rada. Kandidati treba da su državljani Kosova i moraju dostaviti najmanje 3 (tri) preporuke od drugih naučnika ili naučnoistraživačkih institucija, u skladu sa Uputstvo za dodelu nagrada . Kandidat mora da dostave CV i listu koja će biti lako da se proverri za publikacije ili naučnih rezultata u navedenom periodu.

Finansiranje koje je dostupno

Nagrada "Naučnik godine" uključuje nagradu od 2000 eura za podršku nastavak svog istraživačkog rada i za podsticaj pobednike nagrada da se uključe u nove istraživačke inicijative. Naučnik može dobiti samo jednom nagradu u svojoj naučnoj karijeri. Za godinu dana ne može biti dodeljeno više od jedne nagrade za određenu naučnu oblast.

Nagrada "Novi naučnik godine" uključuje nagradu od 1.500 evra i biće dodeljena na godišnjem nivou za 3 (tri) naučnika koji su u povelju istraživačke karijere i bili svedoci visokih naučnih i istraživačkih rezultata i potencijala.

Konkurs ostaje otvoren 10 dana od dana javnog objavljivanja u novinama, na veb stranici MONT-a i elektronskim medijima.

Kompletiranu dokumentaciju dostaviti u arhivi MONT-a.

Krajni rok za dostavljanje dokumenata je 10.12.2018 (ponedeljak).

Aplikacija sa detaljnijim objašnjenjem i detaljnim zahtevom za apliciranje dostupna je na veb stranici <http://masht.rks-gov.net/konkurs>

Aplikacija se mora dostaviti u zapečaćenoj koverti na kojoj je treba biti napisano: aplikacija za nagradu "Naučnik godine" ili "Novi naučnik godine" na adresi: Rr. "Agim Ramadani" b.b. 10000 Priština, Kosovo.

Pored toga, elektronska verzija aplikacije mora biti dostavljena u roku (od 27. novembra do 10. decembra 2018, do 16:00 časova) na adresi: sebahate.jupolli@rks-gov.net na albanskom, engleskom ili srpskom jeziku.

Nepotpune aplikacije neće biti razmatrane.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë/Ministarstvo za Inovacije i preduzetništvo/ Ministry of Innovation and Entrepreneurship

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Departamenti për Inovacion - IN/160

Numri i Konkursit: APF0004480

Vendi i punës: Drejtor i Departamentit të Inovacionit

Koeficienti : 10.00

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Periudha provuese: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Mbikëqyrësi: Sekretari i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheqë dhe cakton objektivat e departamentit në përputhje me strategjinë dhe objektivat e institucionit dhe dizajnon planet vjetore të punës të detajuara për t'i përmbushur këto objektiva.
- Menaxhon stafin dhe buxhetin e departamentit dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore që janë relevante me funksionet e departamentit.
- Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë.
- Zhvillon dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe procedurave dhe ofrimin e shërbimeve rreth politikave/strategjive, legjislacionit dhe procedurave në fushën e Inovacionit.
- Zhvillon dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe procedurave dhe ofrimin e shërbimeve rreth politikave/strategjive, legjislacionit dhe procedurave në fushën e Teknologjisë.
- Drejton funksionimin dhe administrimin e sistemit për projektet me fokus në fushën e inovacionit dhe teknologjisë të të gjithë sektorëve.
- Drejton funksionimin dhe administrimin e sistemit të programeve (fondeve) për inovacion dhe teknologji dhe propozon politika për rregullimin e tregut të brendshëm për Inovacion dhe teknologji, përfshirë masat fiskale dhe jofiskale për zhvillimin e sektorëve në inovacione dhe teknologji.
- Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara.

Kualifikimi i nevojshëm :

- Diplomë universitare në : inxhinieri, ekonomi, juridik, administratë publike;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale dhe së paku 4 vite përvojë pune në pozitë drejtuese;
- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e Inovacionit dhe Teknologjisë;
- Shkathësi të lartë në menaxhim, organizim, caktimit të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocim;
- Qasje fleksibile ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Njohuri të mira të gjuhës angleze, e dëshirueshme.

Procedura e konkurrimit

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në Ndërtesën e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, rr Bajram Kelmendi K1-L1 edhe në Web faqen <http://www.min-rks.net>

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), dëshminë e përvojës së punës, dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm. Kërkesat dorëzohen në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Rruga Luan Haradinaj, (ndërtesa e Punëve të Jashtme, kati i tretë), Prishtinë ose me postë.

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Kohëzgjatja e kontratës sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Afati i konkurrimit është prej datës 27/11/2018 deri me date 11/12/2018, deri në orën 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen. Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 00381 38 200 69 512



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë/Ministarstvo za Inovacije i preduzetništvo/ Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Ministarstvo za Inovacije i preduzetništvo na osnovu Zakona o javnoj službi Republike Kosovo br.03/L-149 i Uredbe br. 02/2010 o postupku zapošljavanja u javnoj službi Republike Kosovo, objavljuje:

OGLAS ZA ZAPOSŁJAVANJE

Departman Inovacije

Broj Konkurs: APF0004480

Radno mesto: Direktor Odeljenja za inovacije IN/160

Koeficijent: 10.00

Trajanje imenovanja: Na neodređeno vrijeme

Probni period: 12 (dvanaest) meseci

Nadzornik: Generalni Sekretar

Dužnosti i odgovornosti:

- Rukovodi i određuje ciljeve odeljenja u skladu sa strategijom i ciljevima institucije i dizajnira detaljne godišnje planove za ispunjenje tih ciljeva;
- Rukovodi osobljem i budžetom odeljenja i organizuje rad zadajući zadatke podređenima, pružajući savete i nadgledajući rad osoblja za pružanje kvalitetnih proizvoda i usluga koje su od značaja za funkcionisanje odeljenja;
- Analizuje i ocenjuje interne procese i procedure i preporučuje izmene/poboljšanja u cilju povećanja efikasnosti u radu;
- Razvija i nadgleda sprovođenje politika i procedura i pružanje usluga o politikama/strategijama, zakonodavstvu i procedurama u oblasti inovacija;
- Razvija i nadgleda sprovođenje politika i procedura i pružanje usluga o politikama/strategijama, zakonodavstvu i procedurama u oblasti tehnologije;
- Rukovodi funkcionisanje i administraciju sistema za projekte uz fokus na oblast inovacija i tehnologije u svim sektorima;
- Rukovodi funkcionisanje i administraciju sistema programa (sredstava) za inovacije i tehnologije i predlaže politike za uređenje unutrašnjeg tržišta za inovacije i tehnologije, uključujući fiskalne i nefiskalne mere za razvoj sektora u inovacijama i tehnologijama;
- Redovno ocenjuje osoblje pod njegovim/njenim nadzorom i podržava njihov razvoj kroz obuke za obavljanje zadataka u skladu sa traženim standardima.

Potrebne kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma inženjering, ekonomija, pravo, javna uprava
- Sedam (7) godina stručnog radnog iskustva, uključujući najmanje 4 na upravnom položaju;
- Suštinsko poznavanje i iskustvo u oblasti inovacija i tehnologije;
- Obimne veštine u menadžmentu, organizovanju, određivanju ciljeva i planiranju;
- Dobra znanja o efektivnom nadzoru stručnog rada koji obavljaju podređeni;
- Veštine visokog nivoa u komunikaciji i pregovaranju;
- Fleksibilan pristup organizovanju i nadzoru rada, uključujući rešavanje problema;
- Poznavanje kompjuterskih aplikacijskih programa (Word, Excel, Power Point, Access);
- Poznavanje engleskog jezika, poželjno

Postupak konkurisanja

Postupak konkurisanja je otvoren za spoljne kandidate, kao i za postojeće javne službenike koji uspunjavaju kriterijume konkursa. Prijava za zapošljavanje i opis radnog mesta mogu se preuzeti na zgradi Ministarstvo za Inovacije i Preduzetništvo

Zvanični obrazac za prijavu, možete preuzeti na internet stranici: <http://www.min-rks.net>

Uz zahtev potrebne je priložiti sledeću prateću dokumentaciju: Popunjeni obrazac, dokaz o obrazovnim i stručnim kvalifikacijama (diplome stečene u inostranstvu treba da budu nostrifikovane od strane MONT), dokaz radnog iskustva, dve reference.

Korišćenje pogrešnog obrasca i obrazac nepopunjen traženim podacima, smatraće se nevažećim. Prijave se dostavljaju u zgradi Ministarstvo Inostranih Poslova, III sprat ili putem pošte.

Opšte informacije za sve kandidate

Ministarstvo za Inovacije i Preduzetništvo, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova, i dobrodošle su prijave od svih osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu.

Manjinske zajednice imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima javne službe, kao što je utvrđeno u članu 11. stav 3. Zakona br. 03/L-149 o javnoj službi u Republici Kosovo.

Trajanje ugovora prema ZJS, uključujući i period probnog rada.

Zbog velikog broja primljenih prijava, kontaktiraće se samo kandidati koji uđu u uži izbor.

Rok za prijave je od datuma 27/11/2018 do datuma 11/12/2018, do 16:00

Konkurs će ostati otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi.

Zahtevi podneti nakon isteka roka za konkurs, neće biti uzeti u obzir.

Za dodatne informacije, molimo pozovite sledeći broj: 00381 38 200 69 512.



*Ju uroon festën e
28 Nëntorit*



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA –VLADA -GOVERNMENT

MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE
MINISTARSTVO JAVNE UPRAVE / MINISTRY OF PUBLIC ADMINISTRATION
Kabineti i Ministrit/ Office of the Minister/Ured Ministra

MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE, SHQIPTARËVE KUDO QË JANË, UA URON 28 NËNTORIN-DITËN E FLAMURIT!

THE MINISTRY OF PUBLIC ADMINISTRATION CONGRATULATES ALL ALBANIANS ON THE 28TH NOVEMBER – THE FLAG DAY!

MINISTARSTVO JAVNE UPRAVE SVIM ALBANCIMA GDE GOD DA SU ČESTITA 28 NOVEMBAR DAN ZASTAVE!

KAMU YÖNETİMİ BAKANLIĞI TÜM ARNAVUTLARIN 28 KASIM BAYRAK GÜNÜNÜ TEBRIK EDER!

Mahir Yagcilar, minister



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Urimet Festa e 28 Nëntorit

